



Dashuria

NDAJ PEJGAMBERIT ﷺ

Osman Nuri TOPBASH





Shkodër / 2021

TITULLI ORIGINAL
GÖNÜLLER SULTÂNI EFENDİMİZ'E
MUHABBET

PËRKTHEU
Ilir Hoxha

REDAKTOI
Alban Kali

FAQOSJA
Bledar Xama

BOTIMI I
Prill 2021, Shkodër


PROGRESI BOTIME
Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti
Shkodër, Shqipëri
Mob: +355 67 340 6182

Dashuria

NDAJ PEJGAMBERIT ﷺ

Osman Nuri TOPBASH





PARATHËNIA

Falënderojmë Allahun që na krijoi nga hiçi dhe midis shumë krijesave na bëri qenie njerëzore. Falënderim pa fund për Krijuesin e gjithësisë, na bëri anëtarë të bashkësisë së Muhamedit ﷺ dhe na nderoi me Kuranin, Librin e Tij hyjnor.

Nderime dhe përshëndetje pa fund për Pejgamberin e fundit Muhamedin ﷺ, i cili gjallëroi një shoqëri të tërë të zhytur në arrogancë, mizori dhe padrejtësi duke e lartësuar atë në majat e virtyteve, moralit, kulturës dhe qytetëritë botëror. Po ashtu, nderime dhe përshëndetje për familjen dhe shokët e Pejgamberit ﷺ. Për të jetuar një islam dinamik është e domosdoshme të ndiqet në çdo nivel të jetës, me një rigorozitet të plotë, Kurani dhe tradita profetike. Mënyra më e mirë për ta arritur këtë gjendje është të mbushet zemra me dashurinë për besimin. Sepse kjo dashuri sjell bindje ndaj Pejgamberit ﷺ dhe aftësinë për të përballuar vështirësitë në rrugën e islamit.



Burimi i dashurisë është Allahu. Ai ka vendosur në zemrën e njeriut farën e dashurisë. Prandaj nga kjo pikëpamje mjeti më i mirë për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe për të vazhduar udhëtimin shpirtëror është dashuria.

Dashuria dhe pasioni që është kaplimi i të gjithë ekzistencës si shenjë e rritjes së dashurisë ndaj saj, ndahet në reale dhe alegorike. Pasioni real konsiston në dashurinë ndaj Zotit dhe është kapitali më i madh në rrugën e takimit me Të, ndërsa pasioni alegorik është dashuria dhe varësia ndaj krijesave. Dashuria alegorike e përjetuar brenda kritereve të pëlqimit hyjnor, është një shkallë drejt dashurisë reale dhe një lloj ushtrimi që rrit aftësinë e zemrës për të dashuruar.

Një zemër e ngurtësuar, deri në atë nivel që nuk e ndjen nevojën për dashurinë ndaj Krijuesit dhe Pejgamberit ﷺ, çfarë vlere dhe rëndësie mund të ketë tek Allahu. Rreziku i vërtetë, është afërsia që tregohet ndaj asaj që nuk meriton të dashurohet. Të gjithë njerëzit fitojnë një nivel të caktuar në varësi të vlerës që ka ajo që dashurojnë në këtë jetë.

Ta harxhosh dashurinë në gjëra dhe vende që nuk e meritojnë dashurinë është sikur ujin e pastër të një lumit ta derdhësh në një kënetë me ujë të ndotur. Zhvillimi shpirtëror i njeriut nuk varet vetëm nga dashuria, por edhe nga e kundërta e saj, nga armiqësia që duhet shfaqur në kushte të caktuara. Njeriu ka për të gjetur prehjen në rast se dashuron

dhe urren ato që meritojnë të duhen dhe të urrehen, ndërsa në rast të kundërt, ai ka për t'u kthyer në një krijesë të nënçmuar.

Qëllimi përfundimtar i dashurisë ndaj Pejgamberit ﷺ është arritja tek Allahu. Sepse e vetmja mënyrë për të arritur në oqeanin e dashurisë së Allahut është lumi i dashurisë dhe mëshirës së Profetit ﷺ. Në këtë aspekt niveli më i lartë i dashurisë njerëzore që mund të arrihet është dashuria që ushqehet për Pejgamberin ﷺ. Pa e dashur dhe respektuar siç duhet Profetin ﷺ, nuk është e mundur ta njohim dhe të përfitojmë siç duhet prej tij sepse për të njohur duhet të afrohesh dhe për t'u afruar duhet të duash.

Profetin ﷺ, mund ta njohim aq sa dashuri ndiejmë për të dhe aq sa mund t'i afrohemi atij, sepse, dashuria midis dy të dashuruarve, përjetohet aq sa është edhe forca e dashurisë. Pra, edhe hadithi *"Njeriu është me atë që do"*. (Buhari, Edeb, 96), shpreh këtë bashkim zemrash. I dashuruari, i ngjan të dashurit dhe merr pjesë prej karakterit të tij, vetëm në masën e dashurisë që ndjen për të. Përfitimi shpirtëror më i mirë që duhet të marrim prej të Dërguarit të Allahut, është bashkimi i botës sonë të brendshme me ndjenjat e tij shpirtërore.

Dashuria që ushqejmë ndaj Pejgamberit ﷺ duhet të pasqyrohet si qetësi në adhurim, si mirësjellje në marrëdhëniet njerëzore, si finesë në moral, si dhembshuri në zemër, si nur në fytyrë, si urtësi në gjuhë dhe si mësim në shikim.

Profeti ﷺ është një model konkret që na qartëson konceptin e devotshmërisë me të cilën na ka urdhëruar Zoti ynë dhe një personalitet shembullor e i pashoq. Nisur nga kjo, rruga e cila të çon në dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, kalon nga “Bindja me dashuri ndaj Profetit ﷺ”. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”. (Al-i Imran, 31)

Afrimiteti shpirtëror me Pejgamberin ﷺ dhe ndjekja e rrugës së tij në gjendje dhe vepra, pra shkurtimisht dashuria për të është e vetmja mënyrë për të shpëtuar nga dënimi hyjnor. Allahu në ajetin kuranor thotë:

Por Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre... (Enfal, 31)

Në kohën kur dashuria përdoret për qëllime mesquine, mëshira është lënë pas dore, dhembshuria, altruizmi dhe shumë veti të tjera të larta janë harruar, lind një nevojë shumë herë më e madhe për Pejgamberin e mëshirës ﷺ i cili është dërguar për të plotësuar moralin dhe për t’i dhënë jetë shoqërisë...

Sepse epoka që nuk ka qenë me Profetin ﷺ e dërguar mëshirë për njerëzimin, është quajtur epoka e injorancës...

Zemra që nuk rreh me të është e përfshirë nga një indiferencë e madhe...

Ndërgjegjja që nuk e vlerëson Pejgamberin ﷺ është në një gjendje të mjerueshme.

Prandaj dashurinë për Allahun dhe Pejgamberin ﷺ nuk duhet ta kalojë asgjë, as dashuria për jetën dhe as dashuria për familjen...

Nuk duhet të harrojmë që Pejgamberi ﷺ është pasuria jonë më e madhe shpirtërore. Nëse nuk do të njihnim Pejgamberin ﷺ çfarë vlere do të kishin edhe sikur të zotëronim të gjitha pasuritë e kësaj bote?! Sepse jeta jonë në këtë botë është e përkohshme... Kurse qetësia dhe lumturia që sjell njohja dhe ndjekje e Pejgamberit ﷺ është e përjetshme...

Prandaj sahabët të cilët ishin të mbrujtur me moralin hyjnor, për të plotësuar një dëshirë të vogël të Pejgamberit ﷺ, gjithë entuziazëm dhe dashuri thonin:

Të qoftë falë jeta, pasuria dhe çdo gjë o i Dërguari i Allahut.

Të dashur lexues!

Duhet të pranojmë që fuqia dhe mundësitë tona nuk na e bëjnë të mundur ta njohim si duhet Profetin ﷺ. Ne jemi të paaftë për ta njohur atë si duhet. Perceptimet tona për të janë të cekëta. Sepse ai është si një oqean i paanë. Dhe përfshirja e një oqeani në një gotë ujë është e pamundur.

Perceptimi ynë, përballë madhështisë reale të Pejgamberit ﷺ, dhe përballë ndodhive sublime metafizike, nuk ka ndonjë dallim nga perceptimi i një fëmije. Sepse Allahu i ka dhënë Pejgamberit ﷺ një pozitë shumë të lartë, aq të lartë sa që njerëzimi e ka të pamundur ta kuptojë dhe shpjegojë atë me kapacitet e kufizuar perceptuese dhe gjuhësore. Ajo që ne përpiqemi të tregojmë është si një pikë ujë nga deti.

Sepse Ai ishte një mëshirë e tillë:

Mëshira që, po të mos ekzistonte, të gjitha botët do të ishin shndërruar në shkretëtira

Një e tillë mëshirë që, të gjithë pejgamberët që u shfaqën në fytyrën e tokës bartën mirësinë dhe lumturinë e nurit të tij.

Mëshira, drita e së cilës rrezatohet në çdo gjë të bukur që ekziston, pasi bota është krijuar për hir të bukurisë së profetit. Nuk çel asnjë lule në botë, në të cilën të mos reflektohet drita e profetit ﷺ. Ai është gonxhja hyjnore që, jo vetëm nuk thahet kurrë, por bëhet edhe më e freskët, sa më shumë që kalon koha.

Prandaj sahabët, dijetarët, të urtët dhe evlijatë e kanë zbukuruar dhe ndriçuar botën e tyre shpirtërore me dashurinë për Profetin ﷺ.

Për këtë shkak, duke pasur për qëllim të njohim sa më afër këtë Personalitet të lartë, vendosëm të shkruajmë këtë vepër modeste, me gjithë mangësitë

dhe dobësitë që mund të ketë. Detyra jonë parësore është që, në kuadër të mundësive tona, të bëhemi ura, të cilat do të transmetojnë mëshirën dhe paqen e Tij që përfshin tërë botët. E kemi për borxh që, në kuadër të aftësive tona, t’ia prezantojmë gjithë njerëzimit në formën sa më të bukur atë kryevepër që qëndron në kulmin më të lartë. Në veçanti, është nder për ne që ta përfaqësojmë Atë me sjelljen dhe gjendjen tonë në mënyrën më të mirë.

Zot i Madhëruar, na stolis të gjithë ne myslimanët me personalitetin shembullor dhe të pashoq të Profetit ﷺ! Na i shndërro zemrat tona në sarajet e dashurisë së Tij! Na ndihmo në provën tonë të devocionit, të varësisë dhe të nënshtrimit tonë ndaj Tij, që të arrijmë dashurinë dhe pëlqimin hyjnor!


Amin!..

Osman Nuri TOPBASH

Dhjetor 2015

Yskydar





DASHURIA PËR PEJGAMBERIN

Allahu e ka krijuar gjithësinë mbi dashurinë dhe çdo krijesë e bëri argument të ekzistencës së Vet. Njeriu si mrekulli e krijimit hyjnorë është një pasqyrim konkret i dashurisë.

Dashuria është një nga mirësitë më të mëdha që Allahu i ka dhuruar njeriut. Por si të gjitha mirësitë edhe dashuria është objekt i provës. Prandaj dashurinë duhet ta përdorim për zemrat që kanë arritur miqësinë e vërtetë.

Dashuria më e madhe njerëzore që mund të arrihet, padyshim që është dashuria për Pejgamberin ﷺ. Nuk mund të imagjinohet dikush tjetër që e merito dashurinë më shumë se Pejgamberi ﷺ.

Tiparet dhe personaliteti i bekuar i të Dërguarit të Allahut ﷺ, madje edhe vetëm me manifestimet të cilat mund t'i kuptojë logjika e njeriut, paraqesin majën e tërësisë së sjelljeve njerëzore. Ai është vula e profetëve dhe personalitet shembullor i cili plotësoi detyrën e thirrësit në rrugë të drejtë, duke



qenë personalisht shembull konkret. Allahu i Lartë madhëruar e prezanton në Kur'an, atë qenie të bekuar para gjithë njerëzimit, me epitelin "usvei hasene", shembulli më i përkryer, sikurse thuhet në këtë ajet kuranor:

"Ju keni shembullin më të përkryer në të dërguarin e Allahut, kuptohet, për atë që shpre-son në shpërblimin e Allahut në botën tjetër dhe e përmend Allahu shpesh" (Ahzab, 21)

Muhamedi ﷺ në çdo sferë të jetës ka manifestuar një bukuri dhe përsosmëri të pashoqe. Ai posedonte të gjitha bukuritë në shpirt dhe në sjellje. Si rrjedhojë, çdo njeri mund të gjejë në jetën e ndershme dhe synetin, traditën e Profetit ﷺ, sjelljet më të bukura dhe më të përsosura të cilat mund t'i shërbejnë si shembull.

Ai është shembulli më i përsosur

Pejgamberi ﷺ nuk ka ardhur vetëm për të komunikuar mesazhin hyjnor, Ai gjithashtu ka ardhur për të zbatuar një stil jete të përshtatshme me mësimet hyjnore. Ai vetë ka shfaqur një shembull të përkryer përballë çdo situatë. Ky shembull do t'i shërbejë njerëzimit si model për çdo gjë.

Nëse ti je një njeri i pasur, mendo për thjeshtësinë dhe bujarinë e atij Profeti të lartë që sundoi mbi tërë Gadishullin Arabik, që i bëri për vete të gjithë njerëzit e mëdhenj të kombit arab?

Nëse ti je njeri prej të dobëtëve, merr shembull prej jetës së Profetit ﷺ që ka jetuar në Meke nën regjimin e padrejtë dhe mizor të idhujtarëve!

Nëse ti je fitimtar, merr shembull nga jeta e Profetit ﷺ të guximit dhe nënshtrimit që doli fitues mbi armiqtë në Bedër dhe Hunejn!

Dhe, nëse pëson humbje, edhe atëherë kujto Profetin ﷺ i cili i mbështetur fort tek Allahu dh me një durim të pashoq vizitonte dëshmorët dhe sahabët e plagosur në fushëbetejën e Uhudit.

Nëse ti je mësues, mendo për Profetin ﷺ që u mësonte sahabwve, urdhrat hyjnorë duke u përcjellë atyre frymëzimin e zemrës së vet të hollë e të ndjeshme!

Nëse ti je nxënës, përfytyro Profetin ﷺ që rri para Xhebrailit që i ka sjellë shpalljen!

Nëse ti je predikues që jep këshilla ose një pri-jës i besueshëm, dëgjo Profetin ﷺ që u shpërndan urtësi shokëve të vet brenda Xhamisë dhe dëgjoje zërin e zemrës së tij të ëmbël.

Nëse kërkon të mbrosh të vërtetën, ta kumtosh atë, ta lartësosh e të triumfosh me kauzën dhe, për ta bërë këtë, nuk të ndodhet ndonjë ndihmës, shiko e mëso nga jeta e Profetit ﷺ, kur ndodhej në Mekë pa asnjë lloj ndihme, ua shpalli mizorëve të vërtetën dhe i ftoi në rrugë të drejtë!

Nëse ti je një fitimtar që e ke thyer armikun, nëse e ke thyer inatin e kundërshtarit duke dalë

epror mbi të, nëse e ke shkatërruar gënjeshtren dhe e ke shpallur të vërtetën, mbaje të gjallë para syve Profetin ﷺ i cili, ditën e fitores së Mekës, megjithëse ishte një komandant fitimtar, hynte aty me ndjenjë falënderimi, me një thjeshtësi të madhe, i përkulur mbi deve sikur po përkulej në sexhde!

Nëse je pronar çifligu dhe kërkon t'i vësh në rrugë të mbarë punët e atyshme, merr si shembull Profetin ﷺ i cili, pasi u bë pronar i tokave Beni Nadër, Hajber dhe Fedek, vuri në krye të punëve njerëzit që do t'i përmirësonin ato dhe do t'i administronin në rrugë të mirë!

Nëse je njeri pa njeri, mendo për jetimin e vogël të Allahut dhe Amines!

Nëse je një i rritur, shih me kujdes kah jeta e të riut kandidat për profet që punon si çoban i bagëtive së xhaxhait Ebu Talib!

Nëse je një tregtar, kupto situatën e personit më të urtë të karvanit që shkon në Siri dhe në Jemen!

Nëse je gjykatës, mendo zgjidhjen e tij të zgjuar e të drejtë për të vendosur Gurin e zi në Qabe ndërsa fiset mekase janë gati të vrasin njëri-tjetrit për këtë gjë!

Dhe, duke i kthyer sytë sërish nga historia, shih Profetin ﷺ i cili në Medinë, në Faltoren Profetike rri duke i trajtuar para vetes si të barabartë të varfrin e të pasurin.

Nëse je një bashkëshort, shih me kujdes karak-

terin e pastër të atij personi të bekuar, bashkëshorti i Hatixhes dhe Aishes, botën ndijore të thellë dhe dhembshurinë e tij, trajtimin me drejtësi të të gjitha bashkëshorteve!

Nëse je prind, shih mënyrën e sjelljes së tij ndaj vajzës Fatime e ndaj nipërve Hasan dhe Husejn!...

Kushdo që të jesh në cilado kushte që të ndodhesh, mëngjes e mbrëmje, në çdo çast ke për të gjetur Muhamedin ﷺ si prijësin më të mirë dhe udhërrëfyesin më të drejtë!

Ai është një prijës i tillë, me anë të të cilit mund të rregullosh çdo gabim, të vësh në udhë punët që nuk janë rregulluar, të ringjallësh shpresën. Në sajë të dritës dhe udhëzimit të tij mund të shpëtosh nga pengesat e të arrish lumturinë!

Dashuria e madhe

Kur rob të Allahut si Ebu Dheri, Halid bin Zejdi, Hubejb bin Jesafi dhe Rejhane binti Amr hynin në Islam dhe gjenin shpëtim e paqe, në fytyrën e Profetit dukej një gëzim i madh, ngazëllim dhe buzëqeshje. Prehjen dhe lumturinë e të Dërguarit të Allahut ﷺ, Adij bin Hatim ؓ e ka shprehur në këtë mënyrë:

“Kur u bëra musliman, pashë se fytyra e të Dërguarit të Allahut shkëlqeu me një gëzim të madh!” (Ahmed, IV, 378)

Një manifest i mrekullueshëm njerëzor i një

horizonti mëshire dhe ndërgjegjeje nga Profeti i Allahut ﷺ:

“Unë jam më afër çdo besimtari sesa vetja e tij. Kur vdes dikush, pasuria që lë i takon të afërmve të tij. Por nëse lë borxhe dhe jetimë, borxhet më takojnë mua (t’i shlyej), ndërsa për jetimët e kam unë për detyrë të kujdesem.” (Muslim, Xhuma, 43)

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

- Betohem tek Allahu, në duart e të cilit është shpirti im se nuk keni për të hyrë në xhenet, përderisa të mos keni mëshirë për njëri-tjetrin.

Sahabët, që i dëgjuan këto fjalë, thanë:

- O i Dërguari i Allahut! Ne që të gjithë jemi njerëz që kemi mëshirë për të tjerët.

I Dërguari i Allahut tha:

- Mëshira për të cilën e kam fjalën unë, nuk është ajo lloj mëshire që kuptoni ju, pra të keni mëshirë për njëri-tjetrin. Unë flas për mëshirën që përfshin gjithë krijesat! (Hakim, IV, 185/7310)

Ai është një pishtar që ndriçon

Ajeti kuranor në lidhje me Pejgamberin ﷺ thotë:

“O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues, njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton

njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues.” (Ahzab, 45-46)

Si pasojë e këtyre cilësive, Pejgamberi ﷺ e ka nxitur ymetin në përvetësimin e këtyre cilësive. Në çdo rast është përpjekur për të orientuar njerëzit në rrugën e drejtë. Ky hadith që shpreh pikërisht këtë që thamë:

Muadh bin Xhebel رضى الله عنه, thotë:

I thashë të Dërguarit të Allahut ﷺ:

“O i Dërguari i Allahut! Më këshilloni!”

I Dërguari i Allahut tha: “*Ji i Devotshëm ndaj Allahut sa të kesh mundësi! Përkujtoje Allahun pranë çdo guri dhe çdo peme që të gjendesh. Pendohu fshehtas për çdo lloj veprimi të keq që e bën fshehtas ose haptas!*” (Hejthemi, X, 74)

Përsëri një herë tjetër Pejgamberi ﷺ tha:

“O Muadh! Të këshilloj që në fund të çdo namazi të mos e lësh këtë lutje: O Allah! Më ndihmo që të mund të të përkujtoj, që të të falënderoj dhe që të të adhuroj si duhet.” (Ahmed, V, 244-245; Ebu Davud, Vitri, 26)

Kurse Abdullah ibn Amrin e ka këshilluar kështu:

“Abdullah! Mos u bëj si filani sepse ai çohet për namaz nate por tashmë e ka lënë.” (Buhari, Tehexhud, 19)

Ai është kriteri i vetëm për të gjetur të vërtetën

Midis gjithë pejgamberëve, Allahu është betuar vetëm në jetën e Profetit ﷺ: **“Betohem për jetën tënde (o Muhamed), se ata ishin vërtet të përhumbur në dehjen e tyre!”** (Hixhr, 72) Në këtë mënyrë të gjithë vëmendjen e ymetit e ka orientuar në ndjekjen e modelit profetik, në të gjitha aspektet e jetës. Predikuesit si mjet për të udhëzuar njerëzit, juristët si studiues të Kuranit dhe Hadithit, mufesirët si studiueses për kuptimin e Kuranit, mistikët si udhëheqës shpirtëror, mendimtarët si njohës së thelbit të gjërave, artistët si pasqyrues së botës shpirtërore të njerëzimit, të gjitha këto Ymeti islam i ka mësuar prej Profetit ﷺ.

Muslimanët plotësimin e botës e kanë gjetur tek njeriu kurse plotësimin e njeriut e kanë gjetur tek Profeti ﷺ sepse Ai ka qenë gjithmonë pranë gjithë njerëzve, njerëzve të dobët, të varfër, jetimëve, të pashpresëve etj. Ai është për ymetin një dritë që ndriçon në errësirë, një udhëzues i pashoq për atë që ka humbur rrugën.

Sepse njeriu fiton vlerë dhe rëndësi tek Krijuesi i gjithësisë në përpjesëtim të drejt me dashurinë, bindjen dhe ndjekjen e rrugës profetike. Vetëm me ndjekjen e rrugës së Profetit ﷺ është i mundur shpëtimi dhe lumturia në këtë botë dhe botën tjetër.

Allahu prejardhjen e tij e ka përzgjedhur.

Allahu e ka bërë vaxhip dërgimin e salavatit së bashku me Pejgamberin ﷺ edhe të familjes së tij.

Allahu ka kërkuar që të ushqejmë dashuri ndaj të afërmeve të Profetit ﷺ.

Fisin e tij e ka nderuar.

Bashkëshortet e tij i ka bërë nëna të gjithë besimtarëve.

Vajzën e tij e ka bërë zonjë të Xhenetit dhe gjithë grave në botë.

Hatixhen Bashkëshorten e tij, Allahu e ka shpërblyer me një saraj në Xhenet.

Hasanin dhe Hysejnin, dy nipërit e tij i ka bërë dy zotërinjtë e të rinjve në Xhenet.

Hamzain Xhaxhain e tij e ka bërë zotërinë e dëshmorëve.

Sahabët i ka bërë njerëzit më të devotshëm.

Epokën që jetoi e bëri epokën më të shkëlqyer të njerëzimit.

Atëherë, emrin e tij duhet ta shkruajmë në zemrat tona me një bojë që nuk fshihet kurrë. Në mënyrë që zemrat tona të marrin jetë dhe gjallëri. Në zemrat tona të gdhendim fort salavatet dhe emrin e nderuar të Tij.

Kiblen e bëri vend orientimi për të gjithë besimtarët.

Librin e mori vetë Allahu për ta mbrojtur.

Vendlindjen e tij e shpalli të shenjtë.



Qytetin e Medines e shpalli të shenjtë.

Faljen në xhaminë e tij e bëri 1000 herë më me vlerë, gjithashtu e bëri një nga xhamitë për të cilat mund të vizitohet në shenjë nderimi.

Minberin e tij e ka vendosur në Havzin e Xhenetit.

Hapësirën midis shtëpisë dhe Minberit e bëri një prej kopshteve të xhenetit.

Uhudin e bëri prej maleve të Xhenetit.

Ymetin e tij e bëri Ymetin më të mirë të gjithë njerëzimit dhe dëshmitar për gjithë ymetet e tjera.

Madje edhe shejtani që ka qenë afër Pejgamberit ﷺ është bërë musliman.

Përderisa Allahu i ka dhënë kaq shumë mirësi Pejgamberit ﷺ, kjo tregon që ai ka qenë njeriu më i dashur tek Allahut, prandaj edhe ne duhet ta vlerësojmë rëndësinë dhe vlerën e Profetit ﷺ. Ne duhet ta duam dhe respektojmë atë më shumë se veten tonë.

Ibn Abasi thotë:

Allahu nuk ka krijuar njeri më të vyer dhe të shtrenjtë se Pejgamberi ﷺ, sepse unë nuk kam dëgjuar që Zoti të betohet një jetën e dikujt tjetër përveç jetës së Profetit ﷺ. (Ebu Nuajm, Delailu'n Nubuuvve, s. 63, nr. 21; Kadi Ijad, Shifa, I, 105)

Allahu është betuar në jetën e Profetit ﷺ. (Hixhr, 72),

Allahu është betuar në periudhën e tij. (Asr, 1)

Allahu është vetuar në vendin e tij. (Beled, 1-2)

Allahu është betuar në shpalljen e tij. (Jasin, 1-4)


Përfundimisht të gjitha botët kanë gjetur qetësinë e vërtetë vetëm nën çatinë e shpalljes së Profetit të mëshirës. Njerëzimi, i cili deri atëherë ishte duke u përpëlitur në detin e injorancës dhe labirintet e besëtytnive pagane, gjeti portën dhe dritën e shpëtimit. Përmes urtësisë dhe diturisë profetike njerëzimi filloi të rimarrë frymë lirisht. Zemrat e katranosura gjeten jetë në sjelljen dhe atmosferën e tij të mëshirshme. Zemrat e ndotura me padrejtësi, mëkate dhe kryeneçësi u pastruan në lumin e tij dhe u bënë të ndritshme nga drita e besimit.

Por duhet të themi edhe këtë: që edhe Pejgamberi, i Nderuari ynë, nuk është qëllimi i fundit në dashuri. Qenia e vetme që njeriu duhet t'ia kushtojë dashurinë, është Allahu, krijuesi i gjithësisë. Ndërsa dashuria që kemi për Profetin tonë është një shkak dhe rrugë që na prin drejt dashurisë së Allahut.

Lusim Allahun të na bëjë të mundur të jetojmë gjithmonë sipas mësimeve profetike dhe gjendja jonë të jetë sa më afër gjendjes së tij. Lusim Allahun të na bëjë prej robërve që janë ndjekës e shërbëtorë të përkushtuar të rrugës profetike. Lusim Allahun të na ruaj nga rënia në kurthin e kënaqësive të përkohshme të kësaj bote. O Zot na bëj pjesëtarë të grupit të shpëtuar.

Amin!..





PANORAMA DASHURIE

Enes Bin Maliku rrëfen:

“Njëherë një person erdhi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut, kur do të ndodhë Kiameti?”

I Dërguari e pyeti atë:

“Çfarë ke përgatitur ti për botën e përtejme?”

Ai iu përgjigj:

“Dashurinë për të Dërguarin e Allahut!”

Atëherë i Dërguari i Allahut i tha:

“Atëherë ti në atë botë do të jesh së bashku me atë që e do.” (Buhari, Edeb, 96; Muslim, Birr, 164)

Enes Bin Maliku në vazhdim të transmetimit në fjalë thotë:

“Neve nuk na ka gëzuar asnjë lajm tjetër, përveç lajmit për hyrje në islam (pranim të islamit), aq



shumë sa lajmi: “me të vërtetë, ti do të jesh në atë botë së bashku me atë që e do.”

Ja edhe unë e dua Allahun, të Dërguarin e Tij, Ebu Bekrin dhe Omerin dhe, edhe pse nuk mund t'i bëj veprat që bënë ata, shpresoj të jem së bashku me ata në Ahiret. (Muslim, Birr, 163)

Pa mëdyshje, që të hyjë çdo besimtar në kuadër të këtij përgëzimi të të Dërguarit të Allahut duhet të stolisë zemrën e tij me dashurinë, dhe ndriçojë atë me dritën profetike.



Hadithi në vazhdim i përcjellë nga Abdullah bin Hisham ka shumë kuptim kur është çështja për nivelin e dashurisë ndaj Profetit:

“Njëherë ishim në shoqëri me të Dërguarin të Allahut ﷺ, Profeti Fisnik, nga të pranishmit e kishte të kapur për dore Omerin ؓ, atëherë Omeri iu drejtua Profetit dhe i tha:

‘O i Dërguari i Allahut, në përjashtim të vetes sime, ti je më i dashur se çdo gjë tjetër për mua’.

I Dërguari i Allahut në këtë rast i tha Omerit:

“Jo, pasha Zotin, në duart e të cilit është shpirti im, derisa unë nuk jam më i dashur për ty edhe se shpirti yt nuk konsiderohesh se e ke besimin e plotë!”

Atëherë Omeri ؓ tha:

“Pasha Allahun, Ti je më i dashur për mua se



vetja ime?”, kurse i Dërguari i Allahut ia ktheu:

“Tani u plotësua, o Omer!” (Buhari, Iman 3)



Sahabët aq shumë e nderonin, respektonin dhe e donin Profetin,

Sa që kishte prej tyre nuk qethnin flokët vetëm sepse ua kishte prekur i Dërguari i Allahut. (Ebu Davud, Salat, 28/501)

Sa manifestim i bukur i dashurisë profetike është hadithi në të cilin zonjat sahabe motivonin dhe kultivonin dashurinë profetike tek fëmijët e tyre.

Zonjat sahabe qortonin fëmijët e tyre kur ata kalonin kohë të gjatë pa u takuar me të Dërguarin e Allahut.

Kur një herë sahabiu Hudhejfe ؓ kishte disa ditë pa e takuar Profetin, e ëma e tij u zemërua, dhe e qortoi atë. Ja si rrëfen këtë ngjarje vetë Hudhejfeja:

“Nëna më pyeti: Kur je takuar për herë të fundit me të Dërguarin e Allahut?”

Unë i thash:

“Kanë kaluar ca ditë që nuk jam takuar me të Dërguarin e Allahut.” Nëna ime u nxeh dhe më qortoi fort.

Unë i thashë:

“Prit nënë, mos u nxeh do të shkoj menjë-



herë tek i Dërguari i Allahut, do të fal namazin e mbrëmjes së bashku me të, dhe do ta lus që të bëj dua për ty dhe për mua!.." (Tirmidhi, Menakib, 30/3781; Ahmed, V, 391-392)



Në besëlidhjen e dytë të Akabesë Mus'ab ibn Umejri para se të shkonte në shtëpinë e vet shkoi pranë Profetit ﷺ për ta njoftuar se banorët e Medinës po e përqaфонin me shpejtësi Islamin. Me lajmet që i çoi Mus'abi, Profeti ﷺ u gëzua shumë.

Kur nënës politeiste të Mus'abit i shkoi në vesh se i biri kishte shkuar te i Dërguari i Allahut ﷺ para se të shkonte tek ajo, u nxeh shumë. Kurse Mus'abi tha:

"Unë nuk shkoj te askush para se të shkoj te i Dërguari i Allahut ﷺ, askujt nuk i jap përparësi ndaj tij!"

Pasi i mori leje Profetit, Mus'abi shkoi te e ëma dhe e ftoi në Islam. (Ibni Sa'd, III, 119)

Nga dashuria e madhe për Profetin ﷺ, sahabët kur ktheheshin nga një udhëtim, fillimisht shkonin për të takuar Profetin ﷺ vetëm pasi çmalleshin me të shkonin në shtëpitë e veta. (Ahmed, IV, 437-438)



bjen e të birit dhe kishte dalë për ta kërkuar. Kur e mësoi se Zejdi ndodhej në Mekë, u nis menjëherë së bashku me të vëllezërit, arritën në Mekë dhe takuan Profetin ﷺ. Ata i kërkuar t'ia kthente Zejdin. Profeti u tha:

“Urdhëroni, ai është këtu nëse dëshiron të vijë, unë nuk e pengoj?”

Thirreni atë dhe lëreni të lirë të zgjedhë. Po ju zgjodhi ju, nuk keni për të paguar asgjë! Por po më zgjodhi mua, vallahi, unë nuk lëshoj askënd që dëshiron të rrijë me mua!” - u tha Profeti ﷺ.

Kurse Zejdi tha:

“Vallahi, o Emin, unë nuk vë asnjëri para teje! Ti më je bërë baba dhe nënë! Unë do të rri me ty!”.
(Tirmidhi, Menakib, 39/3815)



Sefine rrëfen:

Unë isha skllav i Ummu Selemit, një ditë më tha:

“Do të lej të lirë me kusht që t'i shërbesh të Dërguarit të Allahut.”

Kurse unë i thashë:

“Edhe sikur të më liroje pa asnjë kusht, unë nuk do të ndahem nga i Dërguari deri sa të jem gjallë. Mua më liroi më këtë kusht.” (Ebu Davud, Itk, 3/3936)



Herë pas here dashuria ndaj Profetit ﷺ, përveç tek njerëzit është shfaqur edhe tek bimët dhe kafshët. Një shembull të kësaj dashurie e rrëfen skllavi i liruar i Porifetit ﷺ, Sefine ﷺ.

Isha thellë në det kur papritmas u shkatrua anija. U mbajta pas një cope dërrase e cila më nxori në një breg ku kishte shumë luanë. Luanët kur më panë u nisën drejt meje për të më sulmuar.

Unë thashë: O Ebu Haris! Unë jam skllavi i Pejgamberit ﷺ.

Luani ndaloi, mu afrua me përkëdheli dhe u largua. (Hakim, III, 702/6550.)



Xhabir ibn Abdullahu rrëfen:

Një ditë po ktheheshim nga një udhëtim me Pejgamberin ﷺ kur mbërritëm në një nga bahçet e Benu Nexharëve pamë një deve. Kush hynte në bahçe e sulmonte. Pejgamberi ﷺ hyri në Bahçe dhe e thirri devenë, e cila erdhi me brof pranë Profetit ﷺ dhe u ul para Tij, pastaj kërkoi një kapistër, pasi e lidhi ia dorëzoi të zotit. Pastaj i tha njerëzve:

“Të gjitha krijesat e njohin Pejgamberin ﷺ.”

Në një hadith Pejgamberi ﷺ thotë: *“Përveç atyre që janë jobesimtarë prej njerëzve dhe xhinëve, çdo gjë që është në tokë dhe qiell e di që*



unë jam i Dërguari i Allahut.” (Ahmet ibn Hanbel, Musned)



Kur Pejgamberi ﷺ një ditë ishte në bahçen e një Medinasi. Një deve që ndodhej aty vjen me vrap drejt Pejgamberit ﷺ e cila rënkonte por si një njeri që rënkon nga një dhimbje kurse nga sytë i rridhnin lot. Pejgamberi ﷺ i përkëdheli kokën. Pas përkëdheljeve të Pejgamberit ﷺ, deveja u qetësua por si një fëmijë i vogël. Të gjithë po shikonin të mahnitur.

Pejgamberi ﷺ pyeti se kujt ishte kjo deve?

Një djalë tha:

Është e imja o i Dërguari i Allahut.

Pejgamberi ﷺ tha: *“Kjo kafshë e shkretë ka ankesa ndaj teje. Ti e ke lënë pa ngrënë dhe e ke lodhur së tepërmi devenë. Si e përdor në këtë mënyrë këtë kafshë që shërben për të kryer punët dhe Allahu ta ka lënë amanet ty?”* (Ebu Davud, Xhihad, 44)



Ebu Bekri ﷺ gjatë hixhretit ecte herë para, herë pas Profetit. Kur e vuri re këtë, Profeti e pyeti:

“O Ebu Bekr, pse vepron kështu?”

Ebu Bekri ﷺ iu përgjigj:



“O i Dërguari i Allahut, eci kështu sepse ndjej frikë për ty!”

Më në fund, arritën në shpellën Thevr. Besniku i Madh tha:

“O i Dërguari i Allahut, ti prit këtu gjersa unë ta pastroj shpellën!”

Dhe hyri në shpellë. Pastaj, pasi e pastroi shpellën dhe i mbylli vrimat e insekteve dhe brejtësve, i tha:

“Tani mund të vish, o i Dërguari i Allahut!”

(Ibni Kethir, el-Bidaje, III, 222-223)

Në mëngjes kur zbardhi drita, i Dërguari i Allahut e pa Ebu Bekrin, me rroba tejet të grisura dhe e pyeti për shkakun. Kur Ebu Bekri i tregoi çfarë kishte bërë me teshat, i Dërguari u prek dhe u emocionua tej mase, çoi duart lartë dhe iu lut Allahut për Ebu Bekrin.

Kur u afruan idhujtarët tek hyrja e shpellës Ebu Bekrin e kapi paniku dhe frika, i tha të Dërguarit të Allahut ﷺ.

“Po të vdes unë, vdes vetëm një njeri, por po të ndodhë gjë ty, shkatërrohet një ummet i tërë!”

Profeti falte namaz në këmbë, kurse Ebu Bekri vëzhgonte. Ai i tha Profetit:

“Fisi yt vazhdon të të kërkojë! Vallahi, unë nuk frikësohem për vete, por se mos të bëjnë ndonjë të keqe ty!”

Profeti i tha Mikut të Shpellës:

“O Ebu Bekr, mos ki frikë! Pa dyshim, Allahu është me ne!” (Ibni Kethir, el-Bidaje, III, 223-224; Dijar-bekri, I, 328-329)



Në shpellën Thevr, një çast, i Dërguari i Allahut ﷺ vuri kokën mbi gjunjët e Ebu Bekrit ﷺ dhe ra në një gjumë të lehtë. Ebu Bekri pa në një vend të shpellës shumë afër tyre një vrimë të vogël. Me mendimin se mos nga vrima del ndonjë insekt apo kafshë tjetër dhe e shqetëson Profetin, Ebu Bekri i vuri këmbën vrimës me kujdes për të mos e zgjuar Profetin. Me të vërtetë, pas një farë kohe, Ebu Bekri pa se kishte pasur të drejtë në mendimin e tij: një gjarpër ia kishte kafshuar keq këmbën duke i përshkuar helmin vdekjeprurës. Aq shumë i dhe-mbi atij shoku të madh, saqë, megjithëse nuk nxori zë, nuk arriti, të ndalte lotët që nisën t'i pikonin nga sytë. Lotët ranë mbi fytyrën e Profetit ﷺ që u zgjua dhe e pyeti shumë i shqetësuar Ebu Bekrin kur e pa në atë gjendje:

“Ç’ke, Ebu Bekr, ç’ka ndodhur?”

“Asgjë, asgjë s’ka ndodhur, o i Dërguari i Allahut!” - iu përgjigj Ebu Bekri ﷺ.

Megjithatë, Profeti nguli këmbë dhe Ebu Bekri ia tregoi si qëndronte puna. (Bejhaki, Delail, II, 477; Ibni Kethir, el-Bidaje, III, 223)



Omeri ﷺ në periudhën e kalifatit të tij kur dëgjoji se disa e mbanin më lart se Ebu Bekrin tha:

Vallahi, Nata e Ebu Bekrit në shpellë me Profetin ﷺ është më e mirë se gjithë fisi i Omerit. Kur Pejgamberi doli për të shkuar në shpellë, Ebu Bekri ishte me të. (Hakim, III, 7/4268)



Bera ﷺ tregon se i ati i saj në çdo çast mundohet të dëgjonte ndonjë kujtim mbi të Dërguarin, dhe në këtë kontekst përcjell këtë ngjarje:

“Ebu Bekri bleu një samar 13 dirhem prej babait tim. Ebu Bekri i tha babait tim:

“Thuaj Berasë që të dërgoj në shtëpinë time këtë samar”, kurse babai im i tha:

“Jo! Derisa të më rrëfesh udhëtimin tënd me të Dërguarin e Allahut prej Mekës deri në Medine, ndërsa idhujtarët mekas u ndiqnin.”

Ebu Bekri filloi të rrëfejë Hixhretin. (Buhari, As'habu'n Nebi, 2; Ahmed, I ;2)



Zejnelabidini, i biri i Husejnit ﷺ thotë:

I mësonin betejat e Pejgamberit ﷺ si kur mësonin një sure nga Kurani. (Ibn Kethir, Siret, II 352)



Kur Aliu ﷺ u martua me Fatimen, Pejgamberi ﷺ i tha Aliut:

“Kërko për një shtëpi.”

Aliu kërkoi dhe gjeti një shtëpi pak larg shtëpisë së Pejgamberit ﷺ. Kur shkoi Profeti ﷺ atje i tha bijës:

“Dëshiroj t’ju marr në një vend më afër meje.”

Fatimja tha: Si kur të flasësh me Harith Ibn Numanin, të na lirojë pak vend afër teje.

Pejgamberi ﷺ tha:

“Harithe e ka ndryshuar edhe më parë vendin për ne prandaj më vjen turp ti them përsëri atij.”

Kur dëgjoji Harithe këto fjalë menjëherë u transferua në një vend tjetër. Erdhi tek Pejgamberi ﷺ dhe i tha këto fjalë mbresëlënëse:

*“O i Dërguari i Allahut dëgjove se dëshiron të transferosh Fatimen afër, ja ku e ke shtëpinë time, ajo është shtëpia më afër shtëpisë tënde. Jeta dhe pasuria ime është e jotja. **Vallahi pasuria që merr prej meje është më e mirë se pasuria që më le mua.**”*

Profeti ﷺ pasi e pohoi tha: *“Të vërtetën po thua, Allahu të dhëntë mirësi dhe begati.”*

Pastaj Aliu dhe Fatimja u transferuan në një

nga shtëpitë e Harises që ishte më afër me Profetin ﷺ. (Ibn-i Sa'd, VIII, 22-23)



Seleme ibn Ekva rrëfen:

Profeti ﷺ mbërriti tek fisi i Eslemit të cilët po garonin dy grupe me shigjeta. I tha atyre:

O Benu Ismail! Hidheni shigjetat. Sepse babai juaj është një shigjetar i zoti. Kurse unë jam me filan person.

Kur dëgjuan këtë fjalë të Pejgamberit ﷺ hezituan të hidhnin shigjetat. Kur i pyeti Pejgamberi ﷺ se përse nuk i hidhnin shigjetat, thanë: Si mund të hedhim shigjetat kur ti je me grupin tjetër. Pejgamberi ﷺ tha: Hidheni se unë jam me të gjithë ju. (Buhari, Enbija, 12)



Kur ushtria Islame vendosi shtabin në Bedr, Sa'd bin Muadh mbajti një fjalim, përmes të cilit shfaqet dashuria që ai kishte ndaj të Dërguarit të Allahut dhe se si dridhej gjatë kohës që fliste:

“O i Dërguari i Allahut! Ne po të ngremë një çadër. Po ashtu edhe kafshët po t'i lëmë afër. Pastaj ne do të luftojmë me armikun. Sa mirë do të qe nëse Allahu do të na jepte forcë dhe na mundësonte fitoren! Në të kundërt, Ti hipi kalit dhe shko te vëllezërit që kemi lënë pas! O i Dërguari i Allahut! Edhe ata të duan shumë sikundër dhe ne. Ata kurrë nuk do



të rrinin pa ardhur, sikur ta dinin se Ti do të hyje në luftë. Allahu të mbron Ty me ata. Ata janë të lidhur me Ty nga shpirti dhe luftojnë pranë teje.”

Pejgamberi ﷺ e falënderoi Sa'din dhe u lut për të. Sa'di ﷺ nxori shpatën dhe bëri rojë te dera e çadrës që kishin ngritur për Të. (Ibn Hisham, II, 260; Vakidi, I, 49)



Abdurrahman bin Auf ؓ, rrëfen këtë histori në të cilën del në pah përkushtimi i sahabëve të nderuar ndaj dashurisë për të Dërguarin e Allahut:

Në ditën e Bedrit pashë nga e djathta dhe e majta, isha në mes dy të rinjve Ensarë. Kjo nuk më pëlqeu shumë. Unë doja të isha ndërmjet disave më të fortë. Njëri prej tyre më pyeti pa e dëgjuar tjetri:

“Xhaxha! A e njeh Ebu Xhehlin?”. Unë i thashë:

“-Po, e njoh! Çfare ke ndërmend t'i bësh?”. Djaloshi tha:

“Me sa kam dëgjuar, ai ka ofenduar të Dërguarin e Allahut! Betohem në Allahun, në dorën e të cilit është jeta ime, se nëse do ta shoh atë, nuk do të ndahem prej tij pa vdekur njëri prej nesh!”

U çudita shumë ndaj kësaj fjale të djaloshit. Edhe djaloshi tjetër më tha të njëjtat gjëra. Tashmë ndjeja një gëzim të madh që gjendesha në mes të



atyre të rinjve. Pak më vonë pashë Ebu Xhehlin që vërvitej në sheshin e luftës dhe u thashë:

“Shikoni, ja ky është ai për të cilin po flisnim!

Djemtë nxorën shpatat menjëherë. Ata vrapuan drejt Ebu Xhehilit dhe e vranë. Këta djem ishin Muadh bin Afra dhe Muadh bin Amr.” (Buhari, Megazi, 10; Muslim, Xhihad, 42)



Xhabir bin Abdullahi tregon:

“Një natë para luftës së Uhudit babai më thirri dhe më tha:

- Ma merr mendja se do të jem i pari person prej sahabëve që do të bie dëshmor. Ti je njeriu më i vlefshëm, me përjashtim të Pejgamberit ﷺ, që do të lë prapa. Unë kam disa hua, shlyeji ato. Sillu mirë përherë me vëllezërit e tu!

Në mëngjes i pari që ra dëshmor në Uhud, ishte babai im. Meqenëse ishim të zënë shumë e varrosëm së bashku me një dëshmor tjetër.

Më pas nuk mundëm ta linim së bashku me një tjetër në të njëjtin varr. Pas gjashtë muajsh e nxorëm nga varri. Dhe çfarë pamë, përveç një veshi, i gjithë trupi ishte ashtu siç kishte qenë në ditën e varrimit. E varrosa në një varr të vetëm. (Buhari, Xhenaiz 78)



Sa'd bin Ebi Uakkas, qëndronte pranë Profetit dhe pa pushim gjuante me shigjeta mbi armikun. Ndërsa Profeti ﷺ, për shkak të sakrificës së tij thoshte:

“Qëlllo o Sa'd! Të qofshin falë babai dhe nëna ime!” Këto fjalë i dëgjoi edhe Aliu, i cili u shpreh kështu:

“Unë nuk e kam dëgjuar kurrë Profetin ﷺ, që përveç Sa'dit t'i thotë dikujt tjetër: “Të qofshin falë babai dhe nëna ime!” (Tirmidhi, Edeb 61, Menakib 26.; Ahmed, I, 92)



Kur Profeti ﷺ u plagos në luftën e Uhudit, tha:

“Allahu Teala është shumë i nxehur me popullin që ka plagosur fytyrën Pejgamberit të Tij!”

Sa'd bin Vakkas ؓ ka thënë:

“Për Zotin, kur dëgjova këtë fjalë të të Dërguarit të Allahut, nuk kam ndjerë zemërim aq të madh për të vrarë asnjë njeri. Sa ç'ndjeva zemërim për të vrarë vëllain tim i cili (e kishte plagosur atë)!”

Kësisoj Sa'di, i cili e kishte zemrën të mbushur me dashurinë e të Dërguarit të Allahut, atë ditë, duke i ndarë rreshtat e idhujtarëve, donte të vriste vëllain e tij, por i Dërguari i Allahut ﷺ e ndaloi. (Vakidi, I, 254)



Talha bin Ubejdullah thotë:

“Në luftën e Uhudit, kur sahabët e të Dërguarit të Allahut u shpërndanë, idhujtarët filluan të sulmojnë dhe e rrethuan të Dërguarin e Allahut nga çdo anë. Unë isha në një gjendje që nuk dija nga ta mbroja nga përpara, nga mbrapa, nga e djathta apo nga e majta prej sulmeve që vinin kundrejt Tij. Nxora shpatën dhe njëherë largova ata që vinin nga përpara dhe pastaj ata që vinin nga mbrapa, së fundi ata u larguan.” (Vakidi, I, 254)



Përsëri në Uhud, Malik bin Zuhejr i cili ishte shigjetari i idhujtarëve, i vërviti një shigjetë të Dërguarit të Allahut. Kur Talha bin Ubejdullah e kuptoi se shigjeta do të godiste të Dërguarin e Allahut ﷺ e nxori dorën përballë shigjetës. Gishti i ngeli sakat për shkak se e qëlloi shigjeta. (Ibn Sa'd, III, 217)



Një pjesë sahabësh, që ishin Muhaxhirë dhe Ensarë, e rrethuan të Dërguarin e Allahut të cilin e donin më shumë se jetën e tyre. Ata i dhanë fjalën Allahut se do të binin dëshmorë përpara të Dërguarit të Allahut, me fjalët:

“Fytyra ime është mburojë përpara fytyrës tënde, trupi im të qoftë falë! Paqja e Allahut qoftë gjithmonë mbi Ty! Kurrë nuk ndahemi nga Ti o i



Dërguari i Allahut!” . Pastaj ata luftuan deri në fund.
(Ibn Sa'd, II, 46; Vakidi, I, 240)



Ebu Talha ishte një shigjetar i shkëlqyer që e tendoste shumë harkun. Në ditën e Uhudit i ishin thyer në dorë dy-tri harqe. Gjithkujt që kalonte pranë tij me torbë shigjetash, i Dërguari i Allahut i thoshte:

“Zbraze torbën e shigjatve te Ebu Talha!” Kur Pejgamberi ynë i Nderuar e ngrinte kokën për të parë idhujtarët që ishin pas tij, Ebu Talha thoshte:

“O i Dërguari i Allahut! Nëna dhe babai im të qofshin falë! Mos e ngri kokën! Mos të qëllon ndonjë shigjetë e idhujtarëve. Kraharoni im qoftë mburojë për kraharonin tënd. Më qëlloftë mua ai që do të të qëllojë Ty!” (Buhari, Megazi, 18)



Edhe Katade bin Numan , duke qëndruar përpara të Dërguarit të Allahut për ta mbrojtur, hodhi shigjeta mbi idhujtarët derisa iu shtrembërua harku. Së fundi edhe ai u godit në sy. Bebja e syrit i ra mbi faqe. I Dërguari i Allahut qante kur e shikonte kështu Kataden. I Nderuari ynë  e mori me dorën e tij beben e syrit të Katades dhe e vendosi në vendin e saj. Pastaj ky sy u bë më i bukur se syri tjetër dhe filloi të shikojë më mire. (Hakim, III, 334/5281; Hejsemi, VI, 113; Ibn Sa'd, III, 453.)



Edhe Ummu Umare رضي الله عنها, e cila ishte nga gratë sahabë që mori pjesë në luftën e Uhudit, ishte prej atyre që e mbronin të Nderuarin tonë Krenarinë e Gjithësisë me shigjetë dhe hark. Pas luftës, i Dërguari i Allahut u kthye në Medinë dhe tha:

“Gjatë luftës, kur kthehesha djathtas dhe majtas, shikoja Ummu Umaren duke luftuar pranë meje.” (Ibn Haxher, el-Isabe, IV, 479)

Me këtë rast zonja Ummu Umare, e cila u ndje e nderuar nga lavdërimet dhe lutjet e ndryshme të Pejgamberit, i tha të Dërguarit të Allahut:

“Lutju Allahut që të bëhemi komshinjtë e Tu në xhennet.” Pejgamberi صلى الله عليه وسلم u lut duke thënë:

“O Zoti im! M’i bëj këta komshi dhe shokë në xhennet!” Mbi këtë Ummu Umare رضي الله عنها tha:

“Tashmë nuk i jap rëndësi asnjë lloj fatkeqësie që mund të vijë në këtë botë!” (Vakidi, I, 273; Ibn Sa’d, VIII, 415)



Kur nga një pjesë besimtarësh të cilët ishin në pesimizëm dhe nuk dinin çfarë të bënin, dëgjoi një thashethem sipas së cilës i Dërguari i Allahut kishte rënë dëshmor, Enes bin Nadr رضي الله عنه bërtiti duke ndjerë një djegie të madhe shpirtërore:

“Çfarë do të bëni në këtë jetë tani që i Dërguari i Allahut ka rënë Dëshmor? Ejani, edhe ju bini dëshmorë duke luftuar si Ai!” dhe vërshoi drejt idhujtarëve. Pas pak, ai piu sherbetin e martirizimit, duke

qenë i plagosur me më shumë se tetëdhjetë plagë.

(Ahmed, III, 253; Ibn Hisham, III, 31)



Në fund të luftës së Uhudit, Profeti ﷺ, u bë merak për gjendjen e Sa'd bin Rebisë رضي الله عنه njërit prej sahabëve, të cilin e donte shumë. Prandaj, urdhëroi një prej sahabëve që të shkonte e ta kërkonte në fushëbetejë. Sahabiu kërkoi shumë, por nuk mundi ta gjejë Sa'din. Kur ishte duke u kthyer, me një shpresë të fundit thërret:

“O Sa'd! Më ka dërguar Profeti. Ai më urdhëroi që ta njoftoja nëse je gjallë apo ke rënë dëshmorë!”

Në atë moment, Sa'di që po përjetonte çastet e fundit dhe nuk kishte fuqi të përgjigjej, kur dëgjoji se Profeti ishte bërë merak për të, mbledhi veten dhe tha:

“Tashmë unë jam midis të vdekurve!” Sahabiu që po e kërkonte shkoi menjëherë pranë Sa'dit dhe e gjeti atë me trup të shpuar e të prerë prej goditjeve të shpatave. Sa'di, duke pëshpëritur fjalët e fundit, tha:

“Për Allahun! Edhe sikur t'ju ketë ngelur fuqi vetëm sa për të lëvizur sytë, nëse nuk e mbroni Resulullahun prej armiqve, por e lini t'i ndodhë ndonjë e keqe, nuk do të keni asnjë të drejtë të justifikoheni përpara Allahut!” (Muuatta, Xhihad, 41.;

Hakim, III, 221/4906.; Ibën Hisham, III, 47)



Gratë sahabe që ndodheshin në Medinetu'l-Munevvera dolën jashtë qytetit me shpresën për të marrë ndonjë lajm që mund të vinte nga sheshi i luftës. Edhe Aishja ؓ ishte ndërmjet tyre. Kur nëna jonë Aishe arriti në vendin e quajtur Harre, takoi Hind bint Amr, e cila ishte një grua e devotshme. Hindi po sillte trupat dëshmorë të bashkëshortit të saj Amr bin Xhemuh, të birit të saj Hallad dhe të vëllait të saj Abdullah, të cilët i kishte ngarkuar në një deve. Aishja ؓ e pyeti:

“Çfarë lajmi kemi?”

Hind bint Amr dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

“-Lajm i mire!, i Dërguari i Allahut është gjallë. Kur Ai është gjallë, çdo fatkeqësi është e lehtë...” (Vakidi, I, 265; Ibn Haxher, Fet’hu'l-Bari, Daru'l-Fikr, III, 216; Ibn Abdilber, el-Istiab, Kajro, III, 1168.)



Edhe një pamje tjetër mësimdhënëse nga Uhudi është kjo:

Në ditën e Uhudit Medineja u trondit me një lajm. Kur thanë: “Muhamedi ؐ është vvarë!”, në qytet filluan klithmat, britmat u ngritën në qiell. Secili doli në rrugë dhe mundohej të merrte ndonjë lajm nga ata që vinin. Kur Sumejra ؓ e cila ishte nga Ensarët, iu dha lajmi se dy bijtë, babai, bashkëshorti dhe vëllai i saj kishin rënë dëshmorë, ajo zonjë e nderuar nuk i dha rëndësi, por çështja e vetme



që e shqetësonte ishte gjendja e të Dërguarit të Allahut:

Ajo pyeste: “A i ka ndodhur gjë Atij?”

Sahabët e nderuar u përgjigjeshin:

“Falenderimi i takon Allahut që Ai është mirë. Ai është gjallë, ashtu si do ti!”

Zonja Sumejra tha:

“Zemra ime nuk qetësohet pa e parë Atë. Më tregoni të Dërguarin e Allahut.”

Kur ia treguan të Dërguarin e Allahut, ajo iu afrua menjëherë, e kapi nga fundi i rrobave dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut, nëna dhe babai im të qofshin falë! **Pasi vura re se Ti je gjallë, asgjë tjetër nuk ka më rëndësi për mua!**” (Vakidi, I, 292; Hejthem, VI, 115)

Ja, ky është kulmi i dashurisë që ndihej ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ, këto janë flijimet dhe shembujt e virtytshëm që shfaqin zemrat besimtare, të cilat mbusheshin dhe entuziazmoheshin me këtë dashuri...



Abdullah ibn Ebi Evfa rrëfen:

Pejgamberi ﷺ bëri umren e prapambetur, bashkë me të bëme edhe ne umren. Kur hyri në Mekë bëri tavaf dhe ne bëmë tavaf bashkë me të.



Pastaj shkoi tek kodrat Safa dhe Merve, edhe ne shkuam me të. Ne nga frika se banorët e Mekës mund të hedhin diçka ishim mbledhur si mburojë rreth Pejgamberit ﷺ. (Buhari, Umre, 11)



Një ditë Pejgamberi ﷺ me Ebu Bekrin, Omerin dhe Osmanin dolën në malin e Uhudit. Mali u dridh. Pejgamberi ﷺ tha:

“Qetësohu o Uhud! Sepse mbi ty është një profet, një besnik dhe dy dëshmorë.” (Buhari, As’habu’n-Nebi, 6; Tirmidhi, Menakib, 18/3703; Nesai, Ahbath, 4)



Si pas një hadithi mutevatir, i transmetuar në shumë rrugë, Pejgamberi ﷺ e mbante hutben mbi një trung hurme. Kur u ndërtua minberi, trungu i hurmës u braktis. Trungu filloi të qajë. Pejgamberi ﷺ e përkëdheli dhe qetësoi trungun e hurmës. (Buhari, Menakib, 25)

Ngjarje të tilla përmbajnë mësimet të mëdha për besimtarët. Kur dashuria e sendeve dhe gjallesave është në këtë mënyrë për Profetin ﷺ imagjinoje si duhet të jetë dashuria jonë për të. Për me tepër që ka ajete dhe hadithe që urdhërojnë për dashurinë dhe bindjen ndaj tij.

Hasan Barsriu ndërsa tregonte ngjarjen e trungut të hurmës me lot në sy thoshte:

O Njerz të Zotit! Një trung peme ushqen dashu-



ri për Pejgamberin ﷺ, sepse është e vetëdijshme për pozitën e lartë të tij. Ka mall për të dhe vuan takimin me të. Kur gjendja është kështu për një trung, imagjinoni si duhet të jetë gjendja juaj ndaj Pejgamberi ﷺ.



Poeti i njohur Xhelaleddin Rumi në mënyrë figurative, duke e bërë të flasë trungun e hurmës, e tregon kështu këtë ngjarje në veprën e tij, Mes-nevi:

“Pejgamberi ﷺ zbriti nga minberi dhe, duke e ledhatuar trungun me duart e bekuara, e pyeti me një mirëkuptim të thellë:

“O trung hurme! Ç’kërkon? Pse po qan? Ç’hall ke?” Trungu i hurmës filloi të flasë me gjuhën e ndjenjave dhe, mes lotëve të nxehtë, i tha:

“O i Dërguari i Allahut! U përvëlova nga ndarja jote! Shpirti më është mbushur me një hidhërim, dëshpërim dhe mall të pa përshkruar! Më parë isha unë ajo shtylla fatbardhë dhe e lumtur ku ti mbështetesh kur mbaje hutbe, kurse tani më ke braktisur dhe je ngjitur mbi një minber të lartë! Tani ai minber është mbështetja jote! Por, o i Dërguari i Allahut, të lutem më jep të drejtë: kush është ajo qenie në këtë botë që mund ta durojë ndarjen prej teje?”

Përballë vajtimit me një dashuri të thellë të



trungut të hurmës, i Dërguari i Allahut ﷺ i tha kështu për ta ngushëlluar dhe qetësuar:

“O trung hurme! Meqë vajtimi yt është prej hidhërimit të ndarjes, kërkomë ç’të duash! A dëshiron t’i lutem Allahut që të të bëjë një pemë të gjallë e të gjelbëruar që rrit fruta për të gjithë njerëzit e lindjes dhe perëndimit? Ose të të bëjë një fidan selvie në xhennet që të mbetesh përjetësisht e re, e freskët dhe e bukur?”

Dhe trungu i hurmës që kishte merituar këtë konsideratë të lartë, si shfaqje të dashurisë përvëluese për të Dërguarin e Allahut ﷺ, i bëri këtë kërkesë:

“O i Dërguari i Allahut! Asnjërën s’e dua! E vetmja dëshirë që kam, është të shkrihem në qenien tënde, prandaj të më groposësh e të më shpëtosh nga ky trup i vdekshëm! Sepse pema, sado e njomë dhe e bukur që të jetë, ushqimin e merr nga dielli dhe uji. Kurse jeta ime u ushqye me bukurinë e dritës tënde! E shijoi kënaqësinë e ngrohjes me ngrohtësinë tënde, e djegies dhe përvëlimit tek ti! Unë tashmë nuk ndahem dot nga kjo kënaqësi e ëmbël dhe e këndshme! Unë dua të mbetem i përjetshëm! Groposmë dhe asgjësomë në atë mënyrë që të ringjallem e të përjetësohem tek Ti, tek bukuria Jote e vetme!”

Dhe ai trung hurme u gropos në tokë me qëllim që ditën e kiametit të ringjallet si njerëzit!”

Rrumiu, përsëri në lidhje me këtë jep këto këshilla:

“O njeri indiferent! Vështro mrekullitë e Musait dhe Ahmedit! Si u bë shkopi gjarpër, si u bë trangu hurmës me vetëdije?

Dëgjoje thelbin e dashurisë prej një trangu dhe nxirr mësim. Mos e burgos veten në dëshirat trupore dhe materiale. Lumturia dhe pozita e vërtetë është përtej trupores dhe materiales. Dije që lumturia e vërtetë arrihet kur shkëputesh nga dëshirat trupore dhe jepesh pas botës së përjetshme.”



Gjithashtu, një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ shkoi te dëshmorët e Uhudit dhe tha:

“Dëshmoj për ta!”

Ebu Bekri ؓ i tha:

“O i Dërguari i Allahut, a nuk jemi ne vëllezërit e tyre? Siç u bënë muslimanë ata, edhe ne u bëmë muslimanë! Siç luftuan ata, edhe ne luftuam!”

Profeti i dha këtë përgjigje:

“Po, e drejtë, vetëm se unë s’e di se ç’gjëra do të sajoni pas meje!”

Ebu Bekri qau e qau dhe pastaj i tha i dëshpëruar:

“Domethënë, ne do të mbetemi pas teje?”

(Muvatta, Xhihad, 32)



I Dërguari i Allahut ﷺ dërgonte mësues te fiset e tjera për t'u mësuar fenë. Edhe fiset Adall dhe Kare kërkuan nga i Dërguari i Allahut që t'u dërgonte dikë për t'ua mësuar fenë. Për këto fise mori rrugën një delegacion i përbërë prej dhjetë vetash, por ky karvan ra në kurth. Tetë nga mësuesit ranë dëshmorë, ndërsa dy të tjerët u kapën rob. Edhe Zejd bin Desine dhe Hubejb radijallahu anhum, të cilët u kapën rob, u martirizuan nga idhujtarët Mekkas. Hubejbën e pyetën para se të binte dëshmor:

“A do të doje që të ishte Pejgamberi në vendin tënd, si shpërblim për shpëtimin e jetës tënde?”

Hubejbi radijallahu anhu, duke ndjerë keqardhje për Ebu Sufjanin i cili bëri këtë pyetje, tha:

“Kurrën e kurrës nuk do të doja që unë të jem te fëmijët e mi, ndërsa Pejgamberi të jetë këtu. Unë nuk dua që atij t'i ngulet qoftë edhe një gjëmb atje ku është.”

Ebu Sufjan, i cili shtangu nga habia që i shkaktoi kjo panoramë e pashoqe dashurie, tha:

“Çudi! Unë kurrë nuk kam parë në këtë botë dy vetë që ta duan njëri-tjetrin aq sa ç'e duan sahabët Muhamedin.” (Vakidi, I, 360; Ibn Sa'd, II, 56)

Hubejbi radijallahu anhu, para se të ekzekutohej, kishte vetëm një dëshirë:

“Ti dërgonte Pejgamberit ﷺ një selam plot me dashuri!..”

Por me kë t'ia dërgonte! I dëshpëruar, ngriti sytë nga qielli dhe iu lut Allahut:

“O Zoti im! Këtu nuk ka kush t'ia dërgojë selamin tim Pejgamberit. Dërgoja Ti selamin tim Atij!

Pikërisht në atë çast, i Dërguari i Allahut, i cili ishte bashkë me sahabët e tij në Medine, tha: “Ue alejhisselam!”, që do të thotë: “Edhe mbi atë qoftë paqja!”. Kur sahabët e dëgjuan këtë shprehje, pyetën me habi:

“O i Dërguari i Allahut! Kujt ia ktheve selamin?” . Pejgamberi tha:

“Ja ktheva selamin vëllait tuaj Hubejbit. Xhebraili më solli selamin e Hubejbit!” (Shik. Buhari, Xhihad 170, Megazi 10, 28; Vakidi, I, 354-363)



Enesi ﷺ tregon:

Për Sahabët nuk kishte njeri më të dashur se Profeti ﷺ. (Ahmed, III, 132,250-251)

Për shkak të dashurisë ndaj Profetit ﷺ sahabët e rinjë garonin me njëri-tjetrin për të dërguar letrat e Profetit ﷺ. Për t'i shërbyer Profetit ﷺ ishin të gatshëm të sakrifikonin çdo gjë. Kapërcenin shkretëtira, male, dete dhe plot vështirësi për të dërguar letrat e Profetit ﷺ në destinacionin e duhur. Sepse qëllimi i tyre i vetëm ishte të zënin një vend në zemrën e Profetit ﷺ.



Bashkëshortja e Profetit ﷺ, Ummu Seleme ﷺ ka thënë:

“Qysh nga çasti i parë kur vumë këmbën në Abisini, Nexhashiu na bëri shumë dhurata dhe na shfaqti konsideratë të lartë. Ai na mbrojti dhe u kujdes vazhdimisht për ne. Ne iu falëm Allahut në siguri dhe qetësi të plotë!” (Ahmed, I, 201-202)

Edhe kujtimi mbi ato ditë i nënës sonë, Ummu Habibe ﷺ, nga emigrantët e Abisinisë, tregon se ç’dashuri të thellë ushqenin muslimanët për të Dërguarin e Allahut ﷺ edhe pse s’e kishin para syve:

“Nexhashiu kishte një skllave me emrin Ebrehe. Ndërsa më ishte lidhur në Abisini kurora me të Dërguarin e Allahut ﷺ dhe po bëja përgatitjet për të shkuar në Medinë, ajo më tha:

“Kam një lutje për ty: t’i japësh selam të Dërguarit të Allahut prej meje dhe t’ia bësh të ditur se kam hyrë në fenë e tij!”

Ebreheja u tregua shumë bujare me mua, ajo ma bëri përgatitjen e rrugës. Sa herë që më vinte pranë, më thoshte:

“Kujdes, mos ma harro lutjen time! Patjetër t’ia japësh selamin tim të Dërguarit të Allahut!”

Kur shkova te i Dërguari i Allahut në Medinë dhe, duke i treguar për përgatitjet e kurorës dhe ndihmën që më kishte dhënë Ebreheja në përgatit-

jet, i dhashë edhe selamin e saj. I Dërguari i Allahut buzëqeshi dhe e mori selamin duke thënë:

“Ve alejhesselam ve rahmetullahi ve berekatuhu!” (Ibni Sa’d, VIII)



Sahabet nuk e duronin dot qëndrimin për shumë kohë larg. Kur njëri nga sahabët nuk e shikonte Pejgamberin ﷺ gjatë një ditë menjëherë fillonte ta kërkonte deri sa ta gjente. Kur i pyeste nëse kishin apo jo ndonjë dëshirë, përgjigjeshin: Nuk duam asgjë tjetër përveç se të jemi pranë të Dërguarit të Allahut ditën e gjykimit.

Pejgamberi ﷺ, Ebu Bekri dhe Omeri kishin shkuar tek Abdullah ibn Mesudi i cili në atë moment po falte namaz. Në namaz po këndonte suren Nisa.

Profeti ﷺ tha: “Kush dëshiron ta lexojë kuranin siç ka zbritur le ta lexojë si Abdullah Ibn Mesudi.”

Pastaj Abdullah ibn Mesudi filloi të lutej. Profeti ﷺ i tha: “Kërko çfarë të duash sepse do të jepet.”

Midis të tjerash në lutjen e Abdullah ibn Mesudit ishte edhe kjo lutje: O Zot kërkoj një besim që nuk dobësohet, Xhenetin më të lartë dhe gjithashtu kërkoj të jem pranë Pejgamberit ﷺ.

Omeri deshi t’i tregonte Abdullahit por ndër-



kohë Ebu Bekri i kishte treguar. Kur e pa Omeri tha:

Në mirësi ti ke qenë gjithmonë i pari. (Ahmed, I, 445; Hakim, III, 358/5386)



Kur Pejgamberi ﷺ, po bënte një bisedë me sahabët, Thevbani ﷺ, po e vështronte të Dashurin e Allahut në mënyrë të çuditshme, krejt i përhumbur. Gjendja e tij ia tërhoqi vëmendjen Resulullahut. Ai, me shumë mëshirë, e pyeti:

-Çfarë ke, o Thevban?

Ashiku i Resulullahut, Thevbani u shpreh:

- Tu bëfsha kurban, unë së bashku me nënë e baba, o Resulullah! Malli për ty më ndez e më përcëllon deri në atë masë, sa, kur jam larg teje, më duket çdo çast burim hidhërimi. Kur në dynja është kaq e dhembshme të qëndruarit larg teje, po në Ahiret sa e rëndë do të jetë!? Në botën tjetër, ju Pejgamberët do të jeni së bashku. Kurse përfundimi im, në lidhje me atë botë, është akoma i paqartë! Nëse nuk do të hyj dot në xhenet, do të privohem nga mundësia për të të shikuar ty! Kjo gjë më mundon e më torturon, o Resulullah!

Më pas, Pejgamberi ﷺ, i dha sihariqin:

“Njeriu do të jetë me atë që do...” (Buhari, Edeb, 96)



Xhafer Sadik transmeton prej babait të tij: Një ditë shkuam tek Xhabir ibn Abdullahu. Kur shkuam na pyeti se kush jemi. Kur i thash që jamë Muhamed ibn Ali ibn Husejn, u emocionua shumë.

Urdhëroni dhe pyetni çfarë të dëshironi.

I bëra pyetje të ndryshme, midis të tjerash i kërkoja të më tregonte haxhin e Pejgamberit ﷺ numëroi me gishta deri në nëntë dhe tha:

Profeti ﷺ priti nëntë vjet. Gjatë kësaj kohë nuk bëri haxh. Në vitin e dhjetë lajmëroi se do të shkonte në haxh. Prandaj filluan të vijnë njerëzit grupe-grupe për të shkuar në haxh. Të gjithë donin të ndjeknin atë për të mësuar haxhin dhe për të jetuar si ai. Të gjithë së bashku u nisëm për haxh...” (Muslim, Haxh, 147-148)



Ebu Musa El Eshari rrëfen:

Unë shkova nga Jemeni pranë Pejgamberit ﷺ. Pejgamberi ﷺ ishte në luginën e Mekës.

Më tha: A ke bërë nijet për haxh?

Po, i thashë.

Mbi bazën e cilit haxh ke hyrë në ihram?

Mbi bazën e haxhit që ka hyrë Pejgamberi ﷺ, Lebejk ja Rabbi, jam nën urdhërin tënd o Zot, thashë.

Profeti ﷺ tha:

“Ke bërë një vepër shumë të mirë! atëherë



bëj tavafin, kryej ecjen midis dy kadrave Safa dhe Merve dhe pastaj dil prej ihramit...” (Buhari, Umre, 11)



Kur Ebu Bekrit ﷺ i binte nga dora kapistra, menjëherë e ndalonte devenë dhe e merrte vetë. Ata që ishin aty, i thanë:

“Mund të na urdhëroje dhe ne ta jepnim!”

Ebu Bekri ﷺ përgjigjej:

“I Dërguari i Allahut më ka urdhëruar që të mos kërkoj asgjë nga njerëzit.” (Ahmed, I, 11)



Said Ibn Musejjeb rrëfen:

E pashë Osmanin ﷺ të ulur në një vend. Kërkoj një ushqim që po gatuhej në zjarr, e mori atë dhe e hëngri. Pastaj u ngrit dhe fali namazin. Pas namazit tha:

O Zot u ula ku ishte ulur Pejgamberi ﷺ, hëng-
ra ku kishte ngrënë ai dhe u fala ku ishte falur ai.
(Ahmed, I, 70)



Përsëri i Dërguari i Allahut ﷺ e kishte këshilluar një grua nga Gafari:

“Merr një enë me ujë, hidh brenda saj kripë.

Pastaj laj me të gjakun që ka rënë në mbulesë!”



Ajo zonjë sahabie e zbatoi këtë këshillë gjatë gjithë jetës me një dashuri të madhe dhe asnjëherë nuk i ka larë rrobat pa i hedhur ujit kripë. Madje edhe kur vdiq ujit të xhenazes së saj i hodhën kripë, sipas amanetit të saj.” (Ebu Davud, Taharet, 122/313)

Sa dashuri e lartë e atij që gjatë gjithë jetës nuk humbet asgjë nga fuqia e dashurisë, po përkundrazi vazhdon ta shtojë!..



Nganjëherë dashuria që sahabët kishin ndaj të Nderuarit tonë entuziazmohej aq shumë, saqë nuk mund ta ndanin të Dërguarin e Allahut ndërmjet tyre. Ka'b bin Uxhre ﷺ tregon këtë ngjarje mësimdhënëse:

“Një ditë po rrinim pranë të Dërguarit të Allahut në xhami. Aty kishte një grup prej Ensarëve, një prej Muhaxhirëve dhe një prej Benihashimit. Filluam të debatojmë për të ditur se cilin grup prej nesh donte më shumë i Dërguari i Allahut? Ne të grupit të Ensarëve thamë:

-Ne i kemi besuar të Dërguarit të Allahut, e ndoqëm Atë kudo dhe luftuam bashkë me Të kundër armiqve të tij. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut ﷺ na do më shumë ne.

Vëllezërit tanë Muhaxhirë thanë:

-Ne kemi bërë hixhret për hir të Allahut dhe të Dërguarit të tij, kemi lënë fëmijët tanë, pasurinë



tonë dhe kemi marrë pjesë në po ato luftëra që keni marrë pjesë edhe ju. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut na do më shumë ne.

Ndërsa vëllezërit tanë nga Benihasim thanë:

-Ne jemi të afërmit e Pejgamberit. Edhe ne kemi marrë pjesë në luftërat në të cilat keni marrë pjesë ju. Për këtë shkak, i Nderuari ynë na do më shumë ne.

I Dërguari i Allahut u afrua dhe tha:

-Ju po thonit diçka, çfarë po flisnit?

Secili prej nesh e përsëriti atë që tha. I Dërguari i Allahut i tha çdo grupi:

-Paskeni folur drejt! Kush mund të pohojë të kundërtën e kësaj? Pastaj pyeti?

-A doni që të gjykoj mes jush?

Ne thamë:

-Sigurisht o i Dërguari i Allahut! Nëna dhe babai ynë të qofshin falë. I Dërguari i Allahut ﷺ tha:

-O grupi i Ensarëve! Unë jam vëllai juaj.

Ensarët thanë me gëzim:

-Allahu ekber! Falënderimi i takon Zotit të Qabes që ne e fituam Atë.

I Dërguari i Allahut ﷺ tha:

-O grupi i Muhaxhirëve! Unë jam prej jush.

Edhe Muhaxhirët duke u gëzuar thanë:

-Allahu ekber! Falënderimi i takon Zotit të Qabes që ne e fituam Atë i Dërguari i Allahut ﷺ tha:

-O Benihashim! Ju jeni nga unë dhe keni ardhur te unë.

Edhe ata të grupit Benihashim thanë të gëzuar:

-Allahu ekber! Falënderimi i takon Zotit të Qabes që ne e fituam Atë. Të gjithë u ngritëm të gëzuar. Çdo grup u gëzua dhe u kënaq me lavdërimin e të Dërguarit të Allahut.” (Hejthemi, X, 14)



Bashkëshortja e Xhaferit ﷺ, Esma binti Umejs thotë:

“Kur Xhaferi me shokë ranë dëshmorë, i Dërguari i Allahut ﷺ na erdhi pranë. Atë ditë kisha bërë tabak dyzet lëkura. Pasi e kisha zënë brumin e bukës, ua pata larë sytë fëmijëve dhe ua pata krehur flokët. I Dërguari i Allahut më qyeti:

“O Esma, ku janë fëmijët e Xhaferit?”

I mori fëmijët në kraharor, i puthi dhe i përkëdheli. Ndërkaq, filluan t’i rridhnin lot nga sytë. Unë e pyeta:

“O i Dërguari i Allahut, nënë e babë t’u bëfshin falë, pse qan? Pse sillesh ashtu ndaj fëmijëve të mi? Apo mos ka ardhur ndonjë lajm i hidhur nga Xhaferi me shokë?”

I Dërguari i Allahut ﷺ m’u përgjigj:

“Po, ata sot ranë dëshmorë!”



Dhe unë nisa të vajtoja duke thënë:

“Mjerë, imzot, mjerë Xhaferi im!

Profeti u ngrit dhe shkoi te e bija, Fatimja, dhe i tha:

“Bëni ushqim për familjen e Xhaferit! Ata sot janë të zënë me hidhërimin që u ka rënë mbi krye!”

Familjes së Xhaferit ﷺ iu çua tri ditë ushqim. Profeti tri ditë nuk shkoi fare te shtëpia e Xhaferit duke i lënë në hallin e vet. Pastaj shkoi dhe u tha:

“Mjaft qatë për tim vëlla! Mos qani më! Këtej e tutje, kujdesi për fëmijët e tim vëllai më takon mua!”

Biri i Xhaferit, Abdullah ﷺ thotë:

I Dërguari i Allahut na çoi si zogj në shtëpinë e vet dhe urdhëroi:

“Më thërrisni një berber!”

Berberi erdhi dhe na qethi flokët. I Dërguari i Allahut ﷺ ngriti duart dhe u lut duke e përsëritur lutjen tri herë:

“Allahu im, ndihmoje familjen e Xhaferit dhe Abdullait bëja dorën të begatshme në tregti!”

Kur erdhi ime ëmë, ia tregova këtë dhe ajo u gëzua shumë. Profeti i tha asaj:

“Ti mos u frikëso aspak për ushqimin dhe kujdesin e këtyre fëmijëve! Unë jam kujdestari i tyre në këtë botë e në tjetrën!” (Ahmed, I, 204-205; Ebu Davud,

Terexhxhul, 13/4192; Ibni Hisham, III, 436; Vakidi, II, 766; Ibni Sa'd, IV, 37)



Të donin atë që donte Pejgamberi, ishte një dëshirë e madhe për sahabët. Enes رضي الله عنه rrëfen:

“Një rrobaqepës e ftoi të Dërguarin e Allahut ﷺ në një drekë që kishte përgatitur. Edhe unë shkova bashkë me të. (I zoti i shtëpisë) na solli në sofër bukë elbi, një supë me kungull dhe mish të thatë. Unë pashë se i Dërguari i Allahut ﷺ veçanërisht zgjidhte të hante kungujt që ishin në pjatë. Që nga ajo ditë vazhdoj ta dua kungullin.” (Buhari, Et’ime 33, Buju’ 30; Muslim, Eshribe 144; Muvatta, Nikah 51)



Xhabiri رضي الله عنه, transmeton:

“Një ditë, Profeti ﷺ, më kapi prej dore dhe më mori në shtëpinë e tij. Nxori një copë bukë dhe pyeti familjen:

- A ka ndonjë gjë tjetër (për ta shoqëruar bukën)?

Ata thanë:

- Nuk ka gjë tjetër, përveç uthullës.

I Dërguari i Allahut tha:

-Sa ushqim i mirë është uthulla!

Që kur dëgjova këto fjalë të Profetit, edhe mua



më pëlqen ta përdor uthullën gjatë ushqimit”. (Muslim, Eshribe, 167-169)



Edhe kjo gjendje e Ebu Bekrit ﷺ është shenja e një dashurie dhe delikatese të pashoq. Në çlirimin e Mekës ai solli te Pejgamberi babain e tij të verbër për t’u bërë mysliman. Kur e pa i Dërguari i Allahut, i tha:

“Përse e ke munduar dhe e ke sjellë këtu babain tënd të moshuar? Ne mund të shkonim te ai.”

Ndërsa Ebu Bekri ﷺ tha:

“E solla te Ti, për arsye që Allahu t’i japë secape.”

Kur Ebu Kuhafe ﷺ, babai i Ebu Bekrit, ia zgjati dorën Krenarisë së Gjithësisë për t’i dhënë besën, Ebu Bekri i cili e donte shumë Pejgamberin, nuk mundi ta mbajë veten dhe filloi të qajë. Kur i Dërguari i Allahut e pyeti me habi Ebu Bekrin se përse po qante, Ebu Bekri ﷺ me lot në sy tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ah sikur kjo dorë që po të zgjatet për të të dhënë besën të mos ishte dora e babait tim, por të ishte dora e xhaxhait tënd Ebu Talibit, dhe sikur Allahu Teala të të gëzonte Ty në vendin tim, kush e di sa do të gëzohesha, sepse Ti e doje shumë atë dhe dëshiroje shumë që ai të besonte...” (Hejthemi, VI, 174; Ibn Sa’d, V, 451)



Transmetohet nga Ebu Hurejra:

Profeti ﷺ dërgoi gjashtë veta për ekspeditë në zonën e Nexhibit. Aty muslimanët kapën rob Thumame ibn Uthalin, prijësin e Jemames. E sollën në Medinë dhe e lidhën pas një shtyllë në xhami.

Kur Pejgamberi ﷺ shkoi pranë tij i tha:

“Çfarë mendon se do të bëj me ty o Thumame?”

Ai u përgjigj:

- Mirësi, o Muhamed. Nëse më vret, do të vrasësh një njeri që është në gjak me ty, e nëse më fal, do të falënderoj për këtë zemërgjerësi. Po nëse dëshiron pasuri, ti vetëm urdhëro e kërko, e unë do të jap sa të duash!

Pejgamberi ﷺ u largua dhe u kthye përsëri ditën tjetër dhe përsëri e pyeti:

“Çfarë mendon se do të bëj me ty o Thumame?”

Ai u përgjigj:

- Nuk mendoj gjë tjetër përveç asaj që të thashë herën tjetër:

Nëse më fal gjakun, do ta di për nder.

Nëse më vret do të vrasësh një njeri që është në gjak me ty. Po nëse dëshiron pasuri, ti vetëm urdhëro e kërko, e unë do të jap sa të duash.

Pejgamberi ﷺ e la në këtë gjendje dhe të nesërmen shkoi tek ai dhe e pyeti:

- Çkemi të re o Thumame?

Ai u përgjigj:

- Tek unë nuk ka asgjë të re, përveç asaj që të thashë më parë:

Nëse më fal gjakun, do ta di për nder.

Nëse më vret do ta vrasësh një njeri që është në gjak me ty. Po nëse dëshiron pasuri, ti vetëm urdhëro e kërko, e unë do të jap sa të duash!

Në atë moment Pejgamberi ﷺ u kthye nga sahabët e tij dhe urdhëroi:

“Lirojeni Thumamen!”

Thumameja menjëherë u largua prej Xhamisë së Pejgamberit ﷺ dhe shkoi tek disa hurma në periferi të Medinës, ku kishte ujë. Aty u ndal, i dha ujë devesë, u pastrua mirë dhe përsëri u kthye në xhami.

Pastaj hyri ne xhami dhe deklaroi shehadetin –dhe tha: “O Muhamed, per Zotin nuk kishte mbi faqen e dheut gjë më të urryer për mua se fytyra jote. Ndërsa tani ajo është më e dashura fytyrë për mua... Për Zotin nuk ka pasur fe që e kam urryer më shumë se fenë tënde, por sot ajo është feja më e dashur për mua. Po ashtu, nuk ka pasur vend më të urryer për mua se vendi yt, por ai sot është vendi më i dashur për mua.”.

Pastaj kërkoi leje nga Profeti ﷺ që te vizitonte Shtëpinë e Shenjte te Allahut. Kur mbërriti në Meke

e akuzuan për tradhti, sikur ai kishte tradhtuar fenë e baballarëve të tyre. Ai u tha: «Jo për Zotin, për-kundrazi iu dorëzova Allahut, Zotit të Gjithësisë, bashkë me Muhamedin. Për Zotin nuk do t'ju vijë nga Jemama (vendbanimi i tij) asnjë kokërr gruri derisa të më japë leje Profeti». (Muslim, Xhihad.59)



Kur po bëheshin përgatitjet për fushatën e Tebukut, sahabet ishin mbërthyer nga emocioni se do të dilnin së bashku me të Dërguarin e Allahut ﷺ për ta sakrifikuar jetën në rrugën e Allahut. Kështu, shtatë sahabë të varfër që futeshin në kategorinë e të përjashtuarve nga lufta, iu drejtuan me lutje Profetit për t'u dhënë nga një kafshë me qëllim që të mund të merrnin pjesë në luftë. Por, kur morën përgjigjen se “nuk u gjetën deve”, u kthyen duke qarë. Atëherë, këta lot të derdhur në rrugën e Allahut, fituan pëlqimin hyjnor dhe Kur'ani urdhëroi:

“(Nuk ka gjynah) **as për ata të cilët, kur vijnë te ti për të kërkuar kafshë shalimi e ti u thua: “Unë nuk mund t'ju siguroj kafshë shalimi”, kthehen me sytë e tyre që u rrjedhin lot, ngaqë nuk mundën të gjenin gjë për të dhënë** (në rrugë të Allahut).” (Teube, 92)

Ndër personat e merituar ndaj konsideratës hyjnore në këtë ajet, Abdurrahman bin Ka'b me Abdullah bin Mugaffel-in, ndërsa po ktheheshin nga i Dërguari i Allahut duke qarë, u takuan me Ibni Jaminin, i cili i pyeti:



“Pse po qani?”

“Ne shkuam te i Dërguari i Allahut që të na gjente kafshë për udhë, por nuk na gjeti dot. Kurse ne s’kemi kafshë transporti që të mund të shkojmë në luftë së bashku me të Dërguarin e Allahut!” – Iu përgjigjën ata.

Ibni Jamin u dha të dyve një deve dhe një sasi hurmash si ushqim për rrugë. Pas kësaj, Abbasi u siguroi kafshë udhëtimi dy të tjerëve që derdhnin lot, kurse Osmani, tre të tjerëve. (Ibni Hisham, IV, 172; Vakidi, III, 994)



Një ngjarje tejet mësimdhënëse nga Tebuku, Vasile bin Eska ؓ e tregon kështu:

“Në ditët kur do të dilnim për në fushatën e Tebukut, thirra kështu në Medinë:

“Kush më merr në kafshën e vet duke i dhënë si shpërblim plaçkën e luftës që ka për të më takuar?”

Një person i moshuar nga ensarët më njoftoi se do të mund të më çonte në luftë me kusht që kafshës t’i hipnim me radhë. Sapo i thashë menjëherë “dakord”, ai më tha:

“Ec, pra, na e bëftë Allahu mbarë!”

Kështu, unë dola në rrugë me një shok të mirë e të mbarë. Edhe Allahu na e mundësoi të marrim plaçkë lufte. Mua më ranë në pjesë disa deve. I mora para dhe ia çova ensarit. Ai më tha:



“Merri devetë prapë dhe shko!”

“Sipas marrëveshjes që bëmë në fillim, këto janë të tuat!” – I thashë. Por ai ma ktheu:

“O vëlla, merre plaçkën tënde të luftës se unë nuk e pata dashur këtë shpërblim! Unë të pata marrë ty për të fituar shpërblim shpirtëror!” (Ebu Davud, Xhihad, 113/2676)



Abdullah bin Sehl me të vëllanë Rafi رضي الله عنه kishin luftuar në Uhud së bashku me Profetin ﷺ dhe ishin kthyer në Medinë të plagosur. Kur dëgjuan se i Dërguari i Allahut i ftoi muslimanët për ta ndjekur armikun, thanë duke dalë menjëherë në rrugë:

“Vallahi ne s’kemi kafshë shale, kurse plagët i kemi të rënda, por a e lëmë fushatën ku ndodhet i Dërguari i Allahut?”

Dhe ata nuk u ndanë asnjë çast nga i Dërguari i Allahut duke e ndihmuar njëri-tjetrin, duke e bartur ai me plagët më të rënda atë me plagët më të lehta!

Besimtarët që shpalosën këto sakrifica, fituan miratimin dhe konsideratën hyjnore:

“Për ata që, edhe pasi janë plagosur, i përgjigjen përsëri thirrjes së Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që bëjnë të mira dhe janë të devotshëm, ka shpërblim të madh!” (Al-i Imran, 172)



Gjatë kohës që ishte sëmurë Pejgamberi ﷺ, Ebu Bekri dhe Abbasi vizituan Ensarët. Ensarët i gjetën duke qarë.

Përse qani? pyeti njëri nga të dy?

Qajmë sepse po kujtonin kohët kur uleshim me Profetin ﷺ.

Ebu Bekri dhe Abbasi shkuan tek Profeti ﷺ dhe i treguan ngjarjen. Profeti ﷺ mbështolli kokën me një pëlhurë të zezë dhe doli në xhami. Pasi falënderoi Allahun tha:

Po ju lë amanet Ensarët. Sepse ata janë shoqët e mi, të besueshmit e mi, bashkudhëtarët e mi, besnikët e mi, ata e mbajtën premtimin e tyre për të më mbrojtur . Tashmë u ka mbetur vetëm të presin xhenetin. Prandaj silluni mirë me ta dhe bëhuni bamirës ndaj tyre. Kushdo që të bëjë mirë nga Ensarët pranojeni e kushdo që të bëjë keq nga Ensarët faleni atë. (Buhari, Xhuma 29, Menakib 25; Muslim, Fedailus-sahabe 176)



Enesi رضي الله عنه rrëfen:

“Kisha dalë në rrugë bashkë me Xherir bin Abdullain. Megjithëse ishte më i moshuar se unë, më shërbente!

“Mos bëj kështu!” – I thashë. Kurse ai ma ktheu:

“Kam parë që ensarët i kanë bërë shumë shërbi-



me të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe jam betuar se po të bëhem bashkudhëtar me ndonjërin prej tyre, do t'i shërbej!" (Buhari, Xhihad, 71; Muslim, Fedailu's-Sahabe, 181)



Në kohën kur të Dërguarit të Allahut iu rëndua sëmundja, u shtuan edhe vuajtjet. Kur Fatimja رضي الله عنها, e pa në këtë gjendje, tha:

"O vuajtja e babait tim!" Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

"(Bija ime!) Prej sot, babai yt s'do të ketë më vuajtje!"

Kur i dërguari i Allahut ﷺ, ndërroi jetë, kësaj here Fatimja رضي الله عنها, tha:

"O brenga ime për babanë, që iu përgjigj ftesës së Krijuesit të vet! O brenga ime për babanë, që tani është në Xhenetu-l Firdeus! O brenga ime për babanë, për të cilin edhe Xhibrili u brengos!" Më pas, kur sahabët e varrosën, Fatimja رضي الله عنها, tha:

"Si guxuat dhe si u bëri zemra të hidhni dhé kaq shpejt mbi të Dërguarin e Allahut?" (Buhari, Megazi, 83. Shih. Ibni Maxhe, Xhenaiz, 65.)



Zonja e Xhenetit, Fatimja pasi mori një grusht dhe nga varri i Pejgamberit ﷺ, i mori erë dhe fërkoj sytë me të tha këtë poezi:

Ç'ndodh me atë që nuhat dheun e Ahmedit?



Aroma të mira gjithë jetën nuhat...
 Me vajtjen e tij në botën e amshimit,
 Më ra një fatkeqësi që do ta bënte ditën
 natë...

Nuk është parë të qeshë më Fatimja عليها السلام pas vdekjes së Pejgamberit ﷺ. (Buhari, Megazi, 83; Darimi, Mukaddime, 14, Shik. Ibn Maxhe, Xhenaiz, 65)



Abdullah bin Zejd el-Ensari një ditë erdhi te i Dërguari i Allahut ﷺ dhe qau duke thënë:

“O i Dërguari i Allahut! Ti je më i dashur për mua se vetja ime, se pasuria ime, se fëmijët e mi dhe se pjesëtarët e familjes sime. Sikur të mos ishte mirësia për të parë, do të dëshiroja të vdisja.”

Kur mbi këtë i Dërguari i Allahut ﷺ e pyeti:

“Përse qan?”, Abdullah bin Zejd رضي الله عنه u përgjigj:

“O i Dërguari i Allahut! Qava duke u shqetësuar se nuk do të shoh Ty, duke menduar se një ditë do të ndërrosh jetë dhe do të vdesim, Ti do të kesh grada të larta me pejgamberët, ndërsa ne, edhe nëse do të hyjmë në xhenet, do të jemi në gradat e ulëta.”

Deti i mëshirës, Pejgamberi ﷺ nuk u përgjigj, urdhëroi heshtje dhe në këtë moment zbriti ky ajet fisnik:

“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit,



do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të singertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!” (Nisa, 69)

Një ditë, kur Abdullah bin Zejd رضي الله عنه po punonte në kopshtin e vet, i biri erdhi tek ai duke iu marrë fryma, dhe me një brengë të madhe i tregoi se i Dërguari i Allahut ﷺ kishte ndërruar jetë. Abdullahu رضي الله عنه i cili u brengos shumë, u lut kështu:

“O Zoti im! M’i merr sytë e mi, që tashmë të mos shikoj asnjë tjetër përveç të vetmin që e doja, Muhamed ﷺ.”

Lutja e Abdullahut رضي الله عنه u pranua dhe menjëherë sytë iu verbuan. (Kurtubi, V, 271)



Kur Profeti ﷺ u largua nga kjo botë për sahabët gjithçka ishte shumë e vështirë. Të dashuruar pas tij sahabët e nderuar nuk mund të rrinin një ditë pa e parë. Ishin ndarë nga ai, nuk do ta shihnin më... Kjo gjendje i mbushte plot me mall e vuajtje...

Sipas rrëfimeve të Kasim ibn Muhamed, njëri nga shokët e Muhamedit ﷺ kishte humbur shikimin. Miqtë shkuan për ta vizituar, por ai nuk shqetësohej fare për humbjen e shikimit. Ja si i priti ai vizitorët:

“Unë i doja ata sy për të parë të Dërguarin e Zotit, por pas vdekjes së tij nuk do të gëzohesha



fare edhe po të kisha sytë më të bukur në zonën e Tubales (Jemen).” (Buhari, el-Edebul, Mufred, no.533, Ibn Sa, III, 313.)



Gjendja e sahabëve pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut ﷺ u ngjante qirinjve që treten duke u djegur nga pikëllimi. Atë ditë zemrat u takuan befasisht me zjarret e mallëngjimit të ndarjes së të Dërguarit të Allahut dhe sahabët kalonin nga një gjendje në tjetrën. Edhe Omeri ﷺ doli nga vetja dhe vuajti shumë derisa Ebu Bekri ﷺ i qetësoi njerëzit, sepse këta zemra të dashuruara që nuk mund të duronin edhe një ditë pa e parë Atë, tashmë nuk do ta shihnin më kurrë në këtë botë të përkohshme.

Edhe disa nga sahabët fisnikë ishin të dashuruar me të Dërguarin e Allahut dhe sëmundjet që ua afronin takimin me të (vdekjen) i shihnin me dashuri, ngaqë do të mund të takoheshin me Allahun dhe të Dërguarin e tij, e kësaj ata i dërgonin të Nderuarit tonë, selamet e tyre plot dashuri. Për shembull, Muhamed bin Munkedir ﷺ i kishte bërë vizitë në ditët e tij të fundit Xhabirit, i cili ishte mik i dashur i të Dërguarit të Allahut. Kur ai e kuptoi se Xhabirit, zemra e të cilit vuante nga malli për të Dërguarin e Allahut, i qe afruar vdekja shumë, i tha: “Bëji selam nga ne të Dërguarit të Allahut ﷺ!” (Ibn Maxhe, Xhenaiz, 4)



Pas vdekjes së Profetit ﷺ, disa sahabë qanin dhe nuk mund të flisnin, kur u kujtohej i Dërguari i Allahut ﷺ. Kur kalonin pranë shtëpisë së Profetit ﷺ, kthenin kokat mënjanë, sepse nuk duronin dot zjarrin e ndarjes dhe nuk arrinin ta shihnin me sy shtëpinë e bekuar të Profetit. Për shembull, Abdullah ibn Omeri ﷺ qante sa herë që përmendej Profeti Muhamed ﷺ. (Darimi, I, 40, Ibn Sad, IV, 168)



Pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut ﷺ, kur do të rrëfehej ndonjë hadith, Ebu Bekri ﷺ fillonte të qante sapo i kujtohej i Dërguari i Allahut dhe fliste me vështirësi.

Ebu Hurejre ﷺ e përshkruan kështu gjendjen e tij:

“Ebu Bekri ﷺ u ngjit në minber dhe tha:

“E dini se, një vit më parë, i Dërguari i Allahut ﷺ kishte qëndruar mes nesh siç po qëndroj unë tani mes jush...”

Dhe nisi të qajë. Pastaj i përsëriti këtë fjalë dhe qau. I përsëriti për të tretën herë dhe, duke mos e mbajtur veten, qau edhe një herë tjetër.” (Shih. Tirmidhi, Deavat, 105)

Megjithëse sa qe gjallë i Dërguari i Allahut ﷺ, Ebu Bekri ﷺ i ndodhej gjithmonë pranë, prapë-seprapë ndjente vazhdimisht mall për të, kurse pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut dhe ndarjes prej



tij, dëshira për t'u ribashkuar me të iu forcua akoma më shumë.



Aishja ؓ e përshkruan kështu emocionin e të atit në çastin e vdekjes për bashkimin e shpejtë me të Dërguarin e Allahut: I sëmurë në shtratin e vdekjes, im atë Ebu Bekri ؓ pyeti:

“Ç’ditë është sot?”

“E hënë!” – i thamë.

Kurse ai na tha:

“Po qe se vdes këtë natë, mos më lini të pres gjer nesër, se, për mua, dita apo nata më e gëzuar është ajo më pranë të Dërguarit të Allahut ؓ!” Ai deshte të thoshte se çasti më i gëzuar për të ishte çasti kur do të takohej me të Dërguarin e Allahut!”

(Ahmed bin Hanbel, I, 8)

Pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut ؓ, Ebu Bekr ؓ, e ndjente veten në kurbet. Ndërsa kur po vdiste, ai ndjehej i entuziazmuar me hixhretin që do të bënte për te Allahu dhe i Dërguari i tij. (Buhari, Xhenaiz, 94; 70)

Sahabët e nderuar, edhe kur transmetonin hadithet fisnike të të Dërguarit të Allahut, tregoheshin shumë të përpiktë, nga frika se mos thoshin ndonjë fjalë jashtë porosive të të Nderuarit tonë.



Amr bin Mejmun tregon kështu:

“Unë shkoja gjithmonë në bisedat fetare të Ibn Mes’udit عليه السلام, që i mbante mbrëmjeve të ditëve të enjteve. Gjatë bisedave të tij, në asnjë rast (për shkak të ndjesisë së tij) nuk e kam dëgjuar të thotë: “I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë...”, por në njërën nga këto mbrëmje ia filloi fjalës kësisoj: “I Dërguari i Allahut ka thënë...”, por përsëri e la fjalën përgjysmë dhe uli kokën. (Pasi prita pak) e hodha vështtrimin kah ai. Ai qëndronte në këmbë, këmisha i qe hapur, nga sytë i rridhnin lot dhe mollzat e faqeve i ishin enjtur. (Pasi qëndroi për pak kohë kështu) e plotësoi fjalën e tij:

“I Dërguari i Allahut ﷺ pati thënë ashtu ose një diçka të tillë.” (Ibn Maxhe, Mukaddime, 3)



Imam Zuhri, dijetari më i madh i brezit të tabiineve, ka qenë njeriu më i qetë dhe më i vetëpërmbytur, por kur i përmendnin të Dërguarin e Allahut ﷺ, ai e humbiste veten dhe bëhej sikur nuk ishte ai që njihje disa çaste më parë. (Kadi Ijad, Shifa, II, 597-598)



Pas vdekjes së të Nderuarit tonë, edhe muezini i tij Bilal el-Habeshi عليه السلام, nga pikëllimi që ndjente nuk mundi ta thirrte më ezanin me atë zë të bukur që trondiste qiejt. Sa herë që Bilali عليه السلام vendoste të thërriste ezanin duke mos u rezistuar këmbënguljeve



të as'habëve, teksa nuk e shikonte më të Dërguarin e Allahut në mihrab, fyti i zihej me lezmë, zëri i ndërpritej dhe nuk ishte në gjendje ta thirrte ezanin. Ai u largua nga Medina dhe shkoi në Sham për të qetësuar zjarrin e dashurisë që e digjte nga brenda. Një natë ai pa në ëndërr të Dërguarin e Allahut ﷺ, i cili e qortoi:

“Ç’është kjo ndarje o Bilal? A nuk të ka ardhur koha për të më vizituar?”. Bilali u zgjua i mërzhitur dhe menjëherë mori rrugën. Shkoi në Medine për të vizituar varrin fisnik të të Profetit ﷺ. Ai po qante pranë varrit të të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe kur e vendosi fytyrën mbi varrin e tij, erdhën nipërit e Pejgamberit Hasani me Hysejn. Bilali filloi t’i puthte. Ata i thanë:

“O Bilal! Duam shumë që ta dëgjojmë ezanin tënd!”.

Pas kësaj Bilali filloi ta thërriste përsëri ezanin. Në atë çast Medina u trondit. Kur ai thirri: “Eshhedu enne Muhamedurr-Rrasulullah”, të gjithë njerëzit, gra e burra, duke kujtuar se u ngjall i Dërguari i Allahut dolën nëpër rrugët e Xhamisë së Profetit. Në Medine nuk ishte parë asnjë ditë që njerëzit të qanin kaq shumë përveç ditën kur ndërroi jetë i Dërguari i Allahut ﷺ. (Ibn Esir, Usdu'l-Gabe, I, 244-245; Dhehebi, Sijer, I, 357-358)



qytetit me qëllimin për të bërë kontroll, pa se në një shtëpi kandili ishte i ndezur. Kur iu afrua shtëpisë dëgjoi se një grua e moshuar po thurte lesh dhe po thoshte këtë poezi:

“Selamet dhe lutjet e të devotshmëve qofshin për Muhamedin ﷺ. O i Dërguari i Allahut! Të gjithë njerëzit e zgjedhur dërgonin bekime për ty. Ti bëje ibadet natën dhe qaje shumë në kohën e agimit. Por ja që vdekja i arrin të gjithë një pas një. Ah sikur ta dija nëse bota tjetër do të më bashkojë me Pejgamberin tim!”

Omeri ﷺ, u ul dhe qau për pak kohë. Pastaj trokiti në derë. Gruaja e moshuar pyeti se kush ishte. Ai iu përgjigj:

“Jam Omer ibn Hattabi.”

Gruaja u shqetësua dhe i tha:

“Çfarë pune mund të ketë Omeri me mua? Çfarë kërkon ai këtu në këtë orë?” Omeri ﷺ, i tha:

“Hape këtë derë për hir të Allahut dhe mos ki frikë!”

Kur gruaja e hapi derën, Omeri ﷺ, i tha:

“Thuaje edhe një herë poezinë që the më parë!”

Gruaja e tha përsëri poezinë. Kur arriti te strofa e fundit, Omeri ﷺ, i tha:

“Ju lutem që të më fusni edhe mua ndërmjet jush!”

Nisur nga kjo kërkesë, gruaja e tha në këtë formë strofën e fundit:

“Ah sikur ta dija nëse bota tjetër do të na bashkojë mua e Omerin me Pejgamberin tonë! O Allah që je falës! Fale Omerin!” Kështu, Omeri ﷺ, u kthye pas i gëzuar. (Ali el-Muttaki, XII, 562/35762.)



Bashkëshortja e Omer ibn Abdulazizit Fatimja tregon: Një ditë shkova pranë tij, e gjeta të ulur mbi sexhade kurse kokën e kishte mbështetur mbi duar dhe në këtë gjendje të thellë meditive qante pa pushim, lotët i njomnin faqet.

E pyeta se çfarë kishte?

Ktheu kokën lehtë dhe tha:

“Fatime! Kam marrë mbi vete barrën më të madhe të këtij ymeti. Ka njerëz që janë të uritur, të varfër, të sëmurë, nevojtar, jetimë, gra të veja, njerëz që iu është bërë padrejtësi, robër lufte në vendet armike, të moshuar dhe shumë të tjerë të cilët kur i mendoj më shtyp presioni i barrës së madhe që kam mbi vete. Ndërgjegjja nuk më gjen qetësi. Nëse Allahu më merr në llogari në ditën e gjykimit dhe nëse Profeti ﷺ më qorton për këtë si do të përgjigjem unë?!”

Një zemër e ndjeshme që përpjet të mos dalë para Profetit ﷺ me mëkate. Sepse Profeti ﷺ në një hadith thotë:



“Qënia ime gjallë është në të mirën tuaj: Ju bisedoni me mua dhe unë bisedoj me ju! Edhe vdekja ime është mirësi për ju: Veprat tuaja më prezantohen mua. Kur shoh punët tuaja të mira, falënderoj Allahun për to. Por kur shoh punët tuaja të këqija, i kërkoj Allahu që t’ju falë.” (Hejthemi, IX, 24) Po ashtu, në Hutben e Lamtumirës, i Dërguari i Allahut r, ka thënë: “Kujdes, mos ma nxini fytyrën (me gjynahe)!” (sih. Hejthemi, III, 271; Hamidullah, el-Uesaik, fq. 367)



Sahabët e nderuar, kur flisnin për të Dërguarin e Allahut ndjenin shumë kënaqësi ta fillonin ligjërimin veçanërisht me disa shprehje që nxirrnin në pah dashurinë e tyre për Të, si “habibi: i dashuri im”, “halili: miku im”. Çdo gjë në këtë botë u kujtonte Mikun e tyre të dashur. Po ashtu, Ebu Dherri رضي الله عنه thoshte: “Për Zotin, kur i Dërguari i Allahut ﷺ kaloi në botën tjetër, na pati lënë në një gjendje të tillë saqë, edhe nëse një zog rrihte krahët në qiell, lëvizja e tij na kujtonte një hadith të të Dërguarit të Allahut, sepse i Nderuari i Botëve na pati thënë: Gjithçka që u afron te xheneti dhe që u largon nga xhehenemi u është sqaruar. (Ahmed, V, 153, 162; Hejthemi, VIII, 263)

Kur Abdullah bin Abbasi pati kënduar një herë në namazin e mbrëmjes suren Murselat, e ëma, Ummul Fadl, i pati thënë: “O bir, duke e kënduar këtë sure, më ri ndeze në zemër mallin për të Dërguarin e Allahut! Se kjo është sureja e fundit



që kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut kur e ka kënduar në namazin e fundit të mbrëmjes që ka drejtuar!” (Buhari, Ezan, 98)



Ukbe bin Harith رضي الله عنه rrëfen:

Një ditë Ebu Bekri رضي الله عنه, pasi kishte falur nama-zin e ikindisë, kishte dalë nga xhamia dhe po ecte bashkë me Aliun. Në atë çast ata panë nipin e të Nderuarit tonë, Hasanin, i cili po luante me fëmijët. Ebu Bekri e kapi menjëherë, e hipi në qafë dhe filloi të thotë: “Babai im të qoftë falë! Për Zotin ky i ngjan të Dërguarit të Allahut dhe jo Aliut!” Aliu po i shi-konte nga pranë me buzëqeshje. (Buhari, Menakib, 23)



Ebu Bekri رضي الله عنه thotë:

“Salavati për Pejgamberin ﷺ i fshin gjynahet më shpejt nga ç’e shuan uji zjarrin. T’i dërgosh salam atij (me dashuri dhe singëritet), është më e vlefshme se sa të lirosh disa skllëvër. Ndërsa, ta duash Resulullahun është më sublime sesa të luftosh me nefsin apo të luftosh me shpatë në rrugë të Allahut.” (Bagdadi, Tarihu Bagdad, VII, 161)



Kur Ebu Bekrit i binte nga dora kapistra, menjë-herë e ndalonte devenë dhe e merrte vetë. Ata që ishin aty, i thanë:



“Mund të na urdhëroje dhe ne ta jepnim!”

Ebu Bekri radijallahu anhu përgjigjej: “I Dërguari i Allahut më ka urdhëruar që të mos kërkoj asgjë nga njerëzit.” (Ahmed, I, 11)

Sa sjellje e hijshme për të mos iu bë barrë njerëzve, e gjitha e lindur nga dashuria për Pejgamberin ﷺ.



Dashuria ndaj të afërmve të të Dërguarit të Allahut dhe dashuria ndaj atyre që donte Ai, ishin nga shenjat e ashabëve. Përshembull, Omeri kishte nëntë copë pjata. Gjithçka që kishte, fruta, gjellëra i vendoste në këto pjata dhe ua dërgonte bashkëshorteve të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ndërsa më në fund ia dërgonte vajzës së tij Hafsa. Nëse kishte ndonjë mangësi në të, e plotësonte nga pjesa e tij. (Muvatta, Zekat, 44)



Omeri ﷺ, i kishte ndarë tri mijë e pesëqind dirhemë Usamës, birit të Zejd ibn Harithesë ﷺ. Ndërsa birit të vet, Abdullahut i kishte dhënë pesëqind dirhemë më pak. Abdullahu ﷺ, i tha babait të tij, Omerit ﷺ, duke e pyetur për shkakun e kësaj:

“Përse i ke dhënë më shumë Usamës sesa mua? Ai nuk ka marrë pjesë më shumë se unë në luftë!”

Omeri ﷺ, i dha këtë përgjigje që është shembullore për dashurinë dhe bindjen ndaj Resulullahut ﷺ:



“Bir! I Dërguari i Allahut ﷺ, e ka pas dashur babain e atij më shumë se babain tënd. Edhe Usamën e ka pas dashur më shumë se ty. Ja pra, për këtë arsye i kam dhënë përparësi më shumë atij që ka dashur i Dërguari i Allahut ﷺ, sesa atij që dua vetë.” (Tirmidhi, Menakib, 39/3813.)

Omeri رضي الله عنه, Ishte betuar duke thënë: “Për Zotin, o i Dërguari i Allahut, ty të dua më shumë se veten.” Ja pra, kjo dashuri i përfshinte edhe ata që i donte Pejgamberi ynë i nderuar.



Një ditë, Zejd bin Thabiti رضي الله عنه po bëhej gati të hipte mbi kafshë. Ibn Abasi رضي الله عنه e kapi për kapistre.

- Mos vepro kështu, por lëre kapistrën, o djali i xhaxhait të Profetit. - i tha Zejdi .

- Ne na kanë urdhëruar që të sillemi në këtë mënyrë me dijetarët dhe ata që janë më të mëdhenj se ne, - i tha Ibn Abasi رضي الله عنه.

- A mund të ta shoh pak dorën. - i tha Zejdi رضي الله عنه.

Kur Ibn Abasi رضي الله عنه i tregoi dorën, Zejdi رضي الله عنه ia puthi atë dhe tha:

- Dhe ne na kanë urdhëruar që të sillemi në këtë mënyrë me Ehli Bejtin e Profetit ﷺ! (Ali el-Mutaki, Kenzul Umal, XIII, 396/37061)



Ibn Omeri رضي الله عنه, transmeton si më poshtë një ngjarje që i ka ndodhur:

“Ishim në një udhëtim me të Dërguarin e Allahut ﷺ. Unë isha mbi një deve të re që i përkiste babait tim, Omerit رضي الله عنه. Atë nuk e ndaloja dot. Kështu që dilja vazhdimisht para njerëzve. Babai mërzitej nga kjo gjendje, vinte, e kalonte devenë pas dhe më thoshte:

“Dili për zot devesë! Të mos kalojë para të Dërguarit të Allahut!”

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ e pa këtë, tha:

“A ma shet mua atë deve, o Omer?” Babai ia shiti duke i thënë: “Ajo është e juaja, o i Dërguari i Allahut.” Pas kësaj Pejgamberi ynë i nderuar tha:

“Abdullah! Deveja është e jotja. Përdore atë si të dëshirosh.” (Buhari, Buju, 47; Hibe, 25/2)



Kur Ibn Omeri رضي الله عنه shkonte për në Mekë, për të kryer haxhin ose umren, i tërhiqte frerët e devesë, kur ajo niste të ecte shpejt dhe thoshte:

- Mos të nxitojmë! Mundet që këmba e devesë të shkelë mbi vendin ku ka shkelur këmba e devesë së Profetit Muhamed ﷺ dhe atëherë edhe unë edhe deveja ime kemi për të qenë nga të lumturit në botën tjetër! (Hatem Umer Taha, Kevkebud durri, Medinetul Munevere 1426, fq. 202)



I Nderuari ynë, Krenaria e Gjithësisë ﷺ duke treguar dashurinë e thellë që ummeti i tij ndjente për të, tha:

“Një pjesë e atyre që do të më duan mua nga ummeti im, do të dalin nga ata që do të vijnë pas meje. Ata janë të gatshëm të sakrifikojnë pasurinë dhe familjen e tyre për të më parë mua.” (Muslim, Xhennet, 12; Hakim, IV, 95)



Sahabët ishin shumë të kujdesshëm ndaj gjërave të Pejgamberit ﷺ, në asnjë mënyrë nuk lejonin që t'i preknin idhujtarët.

Halid bin Velidi, komandanti i madh mysliman, qe hedhur në mesin e radhëve të ushtrisë armike, kur i pati rënë nga koka çallma që mbante, brenda së cilës ruante disa fije nga qimet e mjekrës dhe të flokëve të Profetit ﷺ, nga frika se mos çallma i binte në duart e armikut dhe i përdhosnin ato fije. (Taberani, Kebir, IV, 122)



Ummu Habibe, bashkëshortja e Pejgamberit ﷺ nuk e kishte lejuar babain e saj, të pa bërë musliman akoma, të ulej në vendin e Pejgamberit ﷺ duke i thënë ky është vendi i Pejgamberit, ti nuk je i denjë të ulesh aty. (Ibn Hisham, IV, 12-13)

Po ashtu, një zonjë e nderuar nga sahabet i solli si dhuratë të Dërguarit të Allahut ﷺ xhamadanin



që ia kishte thurur. Ajo i tha: “Këtë e kam thurur me duart e mia, që ta vishni.”



Pejgamberi i cili kishte nevojë për një copë të tillë, e mori, e veshi dhe erdhi pranë sahabëve. Njëri prej tyre i tha:

“Sa e bukur qenka! Ah sikur të ma japësh dhe ta vesh edhe unë, o i Dërguari i Allahut!” I Dërguari i Allahut tha:

“-Mirë!” Pasi qëndroi pak aty, u kthye në shtëpi, e palosi rrobën dhe ia dërgoi sahabiut. Sahabët e nderuar i thanë sahabiut:

“Nuk bëre mirë. I Dërguari i Allahut e veshi atë, sepse kishte nevojë për atë rrobë. Mbi të gjitha ti e kërrove atë nga Pejgamberi ﷺ, duke e ditur se ai nuk e kthen mbrapa bosh atë që i kërkon diçka!”

Mbi këtë sahabiu bëri këtë sqarim: “Për Zotin, unë nuk e doja atë për ta veshur, por për qefinin tim.” (Buhari, Xhenaiz, 28)

Sahabët fisnikë ngashëreheshin me kujtimet që u kishin mbetur nga Profeti ﷺ dhe u kushtonin shumë rëndësi atyre.



Abdullah ibn Unejs rrëfen:

Kisha përfunduar një detyrë të rëndësishme, që më kishte dhënë i Dërguari i Allahut ﷺ dhe shkova



tek ai. Profeti r më mori me vete në shtëpinë e tij, më dha një shkop dhe më tha:

- Ruaje këtë shkop, o Abdullah ibn Unejs!

E mora shkopin dhe, kur shkova tek njerëzit e tjerë, më pyetën:

- Ç'është ky shkop?

- Ma ka dhënë i Dërguari i Allahut ﷺ dhe më ka urdhëruar ta ruaj, - u thashë.

- Përse nuk kthehesh prapë tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe e pyet përse ta ka dhënë ta ruash.
- më thanë.

U ktheva tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe e pyeta:

- O i Dërguari i Allahut! Përse ma ke dhënë ta ruaj këtë shkop?

- Ta kam dhënë, që ta kesh si shenjë që të njoh në Ditën e Kiametit. Atë ditë do të jenë të pakët njerëzit, që do të arrijnë të mbështeten në gjëra të qëndrueshme si shkopi. (Pra njerëzit që do të mund të mbështeten në veprat e tyre të mira, kanë për të qenë të pakët.)

Abdullahu ﷺ e lidhi shkopin për shpatën e tij dhe nuk e mbante kurrë larg vetes. Kur iu afrua vdekja, u la amanet njerëzve të tij që shkopin t'ia vinin brenda në qefin dhe ta varrosnin bashkë me të. Testamentin ia çuan në vend. (Ahmed, III, 496)



Umu Han rrëfen:

Profeti ﷺ erdhi tek unë dhe më kërkoi ujë për të pirë. Unë e qerasa me ujë. Pasi piu ujë, pjesën që mbeti në gotë ma zgjati mua që ta pija. Pasi e piva, i thashë:

- O i Dërguari i Allahut! Unë kisha agjëruar nafile sot, por nuk më bëri zemra ta refuzoja atë që kishte mbetur prej teje! (Ahmed, VI, 343, 424)



Një rivajet i transmetuar nga Sehl bin Sa'd رضي الله عنه është kështu:

Të Dërguarit të Allahut ﷺ i kishin sjellë një pije freskuese. Në anë të djathtë i ndodhej një fëmijë, kurse në të majtë rrinin njerëz të moshuar nga personat e shquar ndër sahabët. Pasi piu pak vetë, Profeti ﷺ i tha me shumë delikatesë dhe hijeshi fëmijës që kishte në të djathtë:

“A më lejon t’ua jap më parë këtë pije freskuese këtyre të mëdhenjve?”

Atëherë, fëmija i zgjuar dha këtë përgjigje që i la të habitur të gjithë dhe që e vlente të bëhej shembull për të gjithë njerëzit:

“O i Dërguari i Allahut! Unë s’ia jap askujt pjesën time që më ka takuar prej teje!”

Dhe Profeti ynë i dashur ia dha fëmijës enën me pijen freskuese që kishte në dorë! (Buhari, Eshribe, 19)



Ebu Xhuhejfe ﷺ tregon kështu:

“Ishte i nxehti i drekës kur i Dërguari i Allahut ﷺ shkoi në zonën Batha. Mori abdest dhe (meqë ndodhej në udhëtim) i fali drekën dhe iqindinë me nga dy rekate. Pas namazit, njerëzit u ngritën, e zunë të Dërguarin e Allahut për duarsh dhe pastaj i fërkuan fytyrat. Edhe unë, ia mora dorën dhe e fërkova mbi fytyrë. Po, ç’të shihja? Dora e tij e bekuar ishte më e freskët se bora dhe me aromë më të këndshme se miskul!” (Ahmed, IV, 309)



Sahabët fisnikë pëlqenin çdo gjë që i pëlqente të Dërguarit të Allahut dhe nuk pëlqenin asgjë që nuk i pëlqente atij.

Enesi ﷺ rrëfen:

“Një rrobaqepës pati përgatitur ushqim dhe e pati ftuar të Dërguarin e Allahut ﷺ. Ai më mori edhe mua me vete. I zoti shtëpisë pati shtruar mbi sofër bukë elbi, supë me kungull dhe mish të thatë, që arabët e quanin kadid. Pashë se i Dërguari i Allahut ﷺ përzgjidhte dhe hante copat e kungullit. Që nga ajo ditë dhe deri më sot, mua më pëlqen shumë të ha kungull. Që nga ajo ditë, kur më pyesin se çfarë dëshiroj të më gatuajnë, u them se, nëse mund të bëjnë ndonjë ushqim që i hidhet edhe kungull, të ma gatuajnë, nëse kanë mundësi.” (Muslim, Eshribe, 144-145)



Për shkak të dashurisë së tyre, sahabët e nderuar bëheshin flutura rreth të Dërguarit të Allahut dhe për çdo fjalë të tij, për çdo urdhër të tij, madje edhe për ndonjë shenjë më të vogël, thonin:

“O i Dërguari i Allahut! Të qofshin falë nëna, babai, pasuria dhe shpirti im!..” Ata të cilët mund t’ia preknin trupin, ndiheshin shumë krenarë me këtë dhe i tregonin duart e tyre duke thënë:

“Ja, me këto dy duar i kam dhënë besën të Dërguarit të Allahut!”. (Ibn Sa’d, IV, 306; Hejthemi, VIII, 42)

Një nga shembujt në lidhje me këtë temë është Ebu Esma esh-Shami ؓ:

Ai pati ardhur te i Dërguari i Allahut si përfaqësues. Pasi mësoi çështjet themelore të Islamit dhe disa çështje që do t’ia dërgonte fisit të cilin përfaqësonte, ai i dha besën të Dërguarit të Allahut duke shtrënguar dorën e tij. Ebu Esma, i cili u trondit me ndjenjën e thellë që përjetoi kur kapi dorën e të Nderuarit tonë, Diellit të dy Botëve, i udhëhequr nga mendimi se duhej ta ndjente gjithmonë begatinë dhe nxehtësinë e asaj dore të bekuar, i dha fjalën vetes se nuk do t’ia jepte më dorën askujt. Dhe në të vërtetë, për tërë jetën e tij, deri sa vdiq, ai nuk ia dha dorën askujt më. (Ibn Haxher, el-Isabe, IV, 7)



Djali i Omerit, Abdullahu, gjithë jetën e tij, që prej fëmijërisë, e kishte ndjekur hap pas hapi të



Dërguarin e Allahut ﷺ. Ai mundohej të bënte çdo gjë që bënte Profeti ﷺ, edhe pse mund të mos e kuptonte urtësinë e tyre.

Nëse e shihte të Dërguarin e Allahut të pinte ujë në një çezmë, shkonte edhe ai e pinte ujë atje. Nëse e shihte të Dërguarin të ulej nën hijen e një peme, ulej edhe ai herë pas here nën hijen e asaj peme. Nëse e shihte Profetin ﷺ, të ulej duke u mbështetur pas një shkëmbi, shkonte edhe ai dhe ulej, duke u mbështetur atje.



Kur ishte duke udhëtuar me një karvan, e ndaloi karvanin në një vend dhe shkoi tek një pemë, e cila ndodhej në një kodër pak më tutje dhe u kthye përsëri. Kur e pyetën për këtë veprim, ai u përgjigj:

“Një ditë, kur po kalonim këtej, Profeti ﷺ, shkoi pranë asaj peme dhe u kthye përsëri...”

Gjendja e këtij sahabi të dashuruar me Profetin ﷺ, të cilin e ndiqte si hija të zotit, është mbresëlënëse edhe në momentet të fundi të jetës.



Enesi رضي الله عنه, transmeton:

“Një ditë, e pashë Profetin ﷺ, të falte gjashtë rekate në namazin e duhasë. Që prej asaj dite, nuk e kam braktisur kurrë atë namaz.”

Hasan Basriu (Allahu e mëshiroftë!), i cili na



e ka sjellë këtë transmetim, me të njëjtat ndjenja, thotë:

“Pas fjalëve të Enesit رضي الله عنه, as unë nuk e braktisa kurrë më atë namaz.” (Taberani, Eusat, II, 68/1276)



Edhe vlerësimi më i vogël i Profetit ﷺ kishte aq vlerë për sahabët, sa nuk e ndërronin me të gjithë botën:

Grupi i fundit i atyre që kishin emigruar më parë në Etiopi, erdhën tek i Dërguari i Allahut me rrugë detare, gjatë marrjes së Hajberit. Në mesin e tyre ishte edhe Esma bint Umejs رضي الله عنها. Kjo grua sahabe erdhi një ditë tek gruaja e Profetit, Hafsaja. Pasi kishin ndenjur një copë herë, erdhi aty edhe Umeri, i cili, kur e pa Esmanë, e pyeti Hafsanë:

- Kush është kjo grua, bija ime?
- Esma bint Umejs! - u përgjigj Hafsaja.
- Ajo etiopiana, - tha Umeri me shaka - që ka marrë pjesë në udhëtimin e fundit me det.
- Po, - u përgjigj Esmaja.
- Ne ua kemi kaluar juve me hixhret, - tha Umeri
- e meritojmë të quhemi më të afërt se ju me të Dërguarin e Allahut ﷺ.

Esmaja رضي الله عنها u prek shumë nga këto fjalë dhe tha:

- Jo, vallahi, ke folur gabim tani, o Umer. Ju



keni qenë pranë të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai ushqente ata që ishin të uritur në mesin tuaj dhe i mësonte ata që nuk dinin prej jush. Ne kemi qenë larg, në Etiopi, ku jetonim në kushte shumë të vështira, mes të huajsh dhe jomyslimanësh. Këtë e bënim për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Betohem tek Allahu, se as nuk kam për të shtënë bukë në gojë dhe as kam për të pirë pikë uji, pa i treguar Profetit ﷺ për këto që më the. Ne kemi duruar halle të ndryshme në Etiopi dhe zemrat i kishim të mbushura plot frikë. Do ta pyesim të Dërguarin e Allahut ﷺ dhe kemi për të parë se kush ka të drejtë. Vallahi, as nuk kam për të gënjer, as kam për t'i shtrembëruar, as kam për të shtuar asnjë gjë fjalëve që me the! Çfarë më ke thënë dhe si ma ke thënë, ashtu kam për t'ia treguar të Dërguarit të Allahut ﷺ!

Esmaja shkoi te Profeti ﷺ dhe i tha:

- O Profeti i Zotit! Umeri më ka thënë kështu e kështu e kështu!

- Po ti, çfarë i ke thënë atij? - e pyeti i Dërguari i Allahut r. - I kam thënë kështu e kështu e kështu. - u përgjigj Esmaja.

- Ai nuk ka më shumë të drejtë sesa juve, në sytë e mi, - tha Profeti ﷺ. - Ai dhe shokët e tij bënë një herë hixhret, ndërsa ju, udhëtarët e anijes, bëtë dy herë hixhret.

Esmaja tregon:

- Kur erdhëm me anije nga Etiopia, një grup sahabësh, mes të cilëve edhe Ebu Musa el-Eshariu, vinin si valët e detit tek ne dhe na pyesnin në lidhje me këtë hadith. Nuk kishte fjalë në botë, që i kishte gëzuar ata më shumë sesa ky hadith i Profetit ﷺ dhe nuk kishin gjë tjetër më të dashur se ai hadith. Në mënyrë të veçantë Ebu Musa ﷺ, më bënte që t'ia tregoja këtë hadith herë pas here dhe nuk dinte të ngopej duke dëgjuar këtë fjalë të të Dërguarit të Allahut. (Buhari, Megazi, 36, Muslim, Fedailus-sahabe, 169)



Abide es-Selmani ishte njëri nga fakihët dhe muhaddithët dijetarë të brezit të Tabiinëve. Ai u bë mysliman dy vjet para vdekjes së Pejgamberit, por nuk pati fatin që ta shikonte. Kjo fjalë e Abide e tregon shumë bukur dashurinë e myslimanëve të parë që ndjenin për të Nderuarin tonë:

“Një qime floku që kam nga i Dërguari i Allahut, është më e vlefshme për mua se sa pasuria e gjithë botës.” (Ahmed, III, 256)

Dijetari i njohur Islam Dhehebi i shprehte kështu ndjenjat e tij kur lexonte fjalët e mësipërme të Abide es-Selmanit, që shfaqnin dashurinë pejgamberike:

“Fjalët e Abides, që preferonin një qime të flokut të të Dërguarit të Allahut më shumë se sa florinj të dhe argjendet që kishin njerëzit, ishin shenjë e një dashurie të lartë. Nëse ky dijetar i madh thotë kështu kur kanë kaluar vetëm pesëdhjetë vjet nga



vdekja e Pejgamberit, po ne pas shtatëqind vjetëve të vdekjes së tij çfarë duhet të themi nëse do të fitojmë një qime floku të Tij, apo ndonjë copë të enës prej dheu në të cilën pinte ujë?

Nëse një njeri i pasur e harxhon pjesën më të madhe të pasurisë së tij për të fituar një gjë të tillë, a do ta shikoje si një njeri që e harxhon pasurinë jo moralisht? Jo, jo! Mos ki frikë nga harxhimi i pasurisë tënde për të vizituar Xhaminë e Profetit, të cilën i Dërguari i Allahut e ka bërë me duart e tij të bekuara, për t'i dhënë selam atij në krye të Dhomës së Lumturisë!

Kur të shkosh në Medinë, shikoje shumë Malin e Uhudit, i cili ishte i dashuri i Tij dhe duaje edhe ti, sepse Pejgamber ﷺ e donte shumë Malin e Uhudit. Mundohu ta bindësh shpirtin tënd, duke shkuar shpesh në Ravzan e Tij dhe në vendet ku qëndronte, sepse nuk mund të jesh besimtar po s'e deshe Atë, të Nderuarin e Gjithësisë më shumë se shpirtin tënd, se fëmijën tënd, se çdo gjë që ke, shkurt, po s'e deshe më shumë se të gjithë njerëzit..." (Dhehebi, Sijer, IV, 42-43)



Krenaria e Gjithësisë ﷺ duke treguar dashurinë e thellë që ummeti i tij ndjente për të, tha:

"Një pjesë e atyre që do të më duan mua nga ummeti im, do të dalin nga ata që do të vijnë pas meje. Ata janë të gatshëm të sakrifikojnë pasurinë

dhe familjen e tyre për të më parë mua.” (Muslim, Xhennet, 12; Hakim, IV, 95)

Ka shumë miq të Allahut që digjeshin me dashurinë e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Disa shembuj nga këta janë:

Abdullah bin Mubarek tregon:

Isha pranë Imam Malikut. Ai po na tregonte disa nga hadithet fisnike të të Dërguarit të Allahut. Në ato momente erdhi një akrep dhe e pickoi disa herë. Ngjyra i ndryshoi, po zverdhej, por nuk e ndërpriste hadithin e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Pasi mbaroi mësimi dhe pasi u shpërndanë njerëzit, i thashë:

“O Ebu Abdullah! Sot po shikoj diçka të çuditshme te ti?”

Ai tha: “Po. Një akrep më pickoi disa herë dhe në të gjitha durova. Munda të qëndroj vetëm nga dashuria dhe respekti që kam ndaj të Dërguarit të Allahut.” (Munavi, III, 333; Suyuti, Miftahu'l-Xhennet, fq. 52)



Imam Maliku jetonte me dëshirën për t'u përsosur me moralin e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Për shkak të respektit që kishte për të Nderuarin tonë, në Medinetu'l-Munevvera ai nuk i hipte kafshës dhe as nuk shkonte në tualet. Kur ishte imam në Ravza, gjithmonë fliste me zë të ulët. Kur halifeja e asaj kohe foli me zë të lartë, ai i tha

“O halife! Ule zërin në këtë vend! Ndëshkimi i



Allahut ka zbritur edhe mbi ata njerëz që janë më të virtytshëm se ti.” Dhe pastaj lexoi këtë ajet fisnik:

“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit dhe mos flisni me të siç flisni me njëri-tjetrin, përndryshe veprat tuaja ju humbin pa e ditur.” (Huxhurat, 2)



Që në moshën e rinisë imam Maliku ishte shumë i përpiktë në respektin ndaj haditheve fisnike të Pejgamberit ﷺ. Krahas respektit që kishte për t'i mësuar ato saktë, i jepte shumë rëndësi edhe dëgjimit në qetësi dhe heshtje. Për këtë shkak, hadithet nuk i dëgjonte në këmbë dhe nuk merrte mësim hadithi kur ishte në vështirësi, i mërzhitur apo në një gjendje të pavendosur. Ai kishte frikë se bënte ndonjë gabim në hadithet fisnike. Një ditë kur e pyetën:

“A ke dëgjuar hadith nga Amr bin Dinar?” ai u përgjigj kështu:

“Unë e kam parë atë kur transmetonte hadithe. Njerëzit ishin në këmbë dhe shkruanin. Ndërsa mua nuk më pëlqen t'i shkruaj në këmbë hadithet fisnike të Pejgamberit tonë të Nderuar.”

Imam Maliku, aq sa kishte frikë kishte edhe një moral të bukur në të gjitha gjendjet dhe mësimet e tij. Fytyra i ndriçonte qoftë kur jepte fetva për disa çështje, qoftë kur transmetonte hadithe fisnike nga Pejgamberi ﷺ. Ai, kur donte të transmetonte hadithet fisnike të Pejgamberit ﷺ, merrte abdes,



përgatitej dhe vishte rrobat më të bukura që kishte. Ai ulej në vend të lartë vetëm kur lexonte hadithet fisnike.

Kur i vinin njerëzit në shtëpi, shërbëtori i tij dilte dhe u thoshte:

“Imami po ju pyet: Doni të dëgjoni hadith, apo do të pyesni ndonjë çështje fikhu? Nëse do të pyesnin për ndonjë çështje fikhu, imami dilte jashtë dhe përgjigjej, por nëse donin të dëgjonin hadith, atëherë u thoshte: Uluni! Pastaj menjëherë shkante dhe merrte gusull, hidhte erë të mirë, vishte rroba të reja, e lidhte çallmën, ulej në një vend të lartë dhe jepte mësim hadithi me frikë respekt ndaj Allahut. Brenda ndizte një lloj peme që shpërthente erë të mirë derisa të mbaronte mësimi.



Rabi bin Sulejman, që ishte nga nxënësit e Imam Shafiut, tregon:

Një ditë Imam Shafiu më tha:

“Rabi, merre këtë letër, dërgoja Ahmed bin Hambelit dhe pastaj më sill përgjigje.”

E mora letrën dhe shkova në Bagdat. Në namazin e sabahut u takova me Ahmet bin Hanbelin. Namazin e sabahut e fala me të. Pasi Imam Ahmedi u largua nga mihrabi, i dorëzova letrën dhe i thashë:

“Këtë letër ta ka dërguar Imam Shafiu, vëllai yt nga Egjipti.” Ai më pyeti:



“A e di se për çfarë bën fjalë letra?” Unë iu përgjigja:

“Jo.” Pastaj Ahmed bin Hanbeli e hapi letrën dhe filloi ta lexojë. Sytë iu mbushën menjëherë më lot. Unë i thashë:

“O Imam! Çfarë ka! Çfarë thuhet në atë letër?” Ai u përgjigj:

“Imam Shafiu ka parë në ëndërr Pejgamberin ﷺ. Pejgamberi i ka thënë:

-Shkruaji një letër Ahmed bin Hanbelit dhe bëji selam nga unë. Ai do të përballet me një fitne të madhe. Do t'i kërkohet që të thotë: “Kur’ani është i krijuar!” Kujdes, të mos i bindet kësaj kërkesë! Allahu do ta lartësojë emrin e tij do ta bëjë të jetojë dhe deri në kiamet.

Unë i thashë:

“O Imam! Sa përgëzim i madh është ky për ty.”

Nga gëzimi që ndjente Imam Ahmedi hoqi këmishën dhe ma dha mua. Pasi mora përgjigjen e letrës, unë u ktheva në Egjipt. Letrën ia dhashë Imam Shafiut. Imam Shafiu më tha:

“Ne nuk duam të të marrim këmishën që ta ka dhuruar ai dhe të të mërzisim, por të paktën fute në ujë atë dhe pastaj ujin na e jep neve, ashtu që edhe ne të jemi ortakë në bereqetin e asaj këmishe. (Shik. Ibnu'l-Xhevi, Menakibu'l-Imam Ahmed bin Hanbel, (skt. Abdullah bin Adulmuhsin et-Turki) Kahire 1409, fq. 609-610)



Dijetari i hadithit dhe muxhtehidi Imam Nevevi, në çdo gjendje dhe lëvizje të tij, e kishte gdhendur në jetën e tij pasimin e të Dërguarit të Allahut dhe kishte marrë nga morali i të Nderuarit tonë aq shumë, sa nuk ka ngrënë shalqi gjatë gjithë jetës vetëm për arsye se nuk e dinte si e ka ngrënë shalqirin i Dërguari i Allahut, duke e thyer, apo duke e prerë.



Po ashtu, është e vlefshme të përmendim edhe dashurinë që kishte Imam Busiri ndaj të Dërguarit të Allahut.

Një ditë, Imam Busiri i cili ishte autori i poezisë së njohur Burde, kur po shkonte në shtëpi, takoi në rrugë një shejh, fytyra e të cilit ndriçonte. I mos-huari e pyeti:

“O Busir! A e ke parë mbrëmë në ëndërr të Dërguarin e Allahut ﷺ? Imam Busiri u përgjigj:

“Jo, nuk e kam parë.”

Pas kësaj bisede të shkurtër, shejhu u largua pa thënë asgjë, por fjalët e tij e entuziazmuan dashurinë që Imami kishte në zemër ndaj Pejgamberit ﷺ. Atë natë Imami e pa në ëndërr Pejgamberin ﷺ dhe kur u zgjua ndjeu se zemra i ishte mbushur me gëzim dhe rehati. Pas kësaj nate ai shkroi shumë poezi që lavdëronin Pejgamberin ﷺ dhe të dashurit e Pejgamberit që ishin mbytur në detin e dashurisë.



Pas një farë kohe, iu paralizua gjysma e trupit. Nuk mund të ecte dhe nuk mund të lëvizte. Atëherë shkruajti poezinë e njohur Burde dhe me të i kërkoi shërim Allahut. Natën që e mbaroi poezinë, pa në ëndërr Pejgamberin ﷺ dhe ia lexoi poezinë Atij. Pasi ia lexoi të tërë poezinë të Dërguarit të Allahut ﷺ, Ai ia fshiu Imam Busirit me duart e tija të bekuara gjymtyrët e paralizuara. Kjo ishte një shenjë aq e thellë dashurie, sa që kur u zgjua nga gjumi, Imam Busiri vuri re se ishte shëruar dhe falenderoi Allahun.

Në mëngjesin e asaj nate, kur po shkonte në xhami i gëzuar dhe i shëruar, takoi në rrugë Shejh Ebu'r-Rexhanë. i tha:

“O Busiri! A mund ta lexosh poezinë në të cilën ke lavdëruar Krenarinë e Botëve?”

Imam Busiri e pyeti:

“Unë kam shkruar shumë poezi që e lavdërojnë në të Dërguarin e Allahut ﷺ. Cilën prej tyre doni ju?”

Shejhu Ebu'r-Rexha tha:

“Dua atë që ia lexove Pejgamberit, sepse pashë që Pejgamberi u kënaq shumë nga kjo poezi.”

Imam Busiri u habit pa masë, ngaqë e dinte mirë se këtë poezi nuk e kishte dëgjuar askush.



ngjalli në zemra dritën dhe mirësinë e Islamit që nga Azia e Mesme e deri në Ballkan, kur hyri në moshën 63 vjeç, hapi një varr në tokë dhe tha:

“Nuk është e nevojshme për mua që të jetoj më mbi këtë tokë pas kësaj moshe!”. Sipas një transmetimi, dhjetë vjet jetë adhurim dhe udhëzim i vazhdoi në varr, me dëshirën për të marrë nga morali i të Dërguarit të Allahut.



Çliruesi i Indisë Gazneli Mahmud kishte një shërbëtor që e donte shumë dhe të cilin e quanin “Muhamed”. Atij i thërriste gjithmonë me emrin e tij. Një ditë ai nuk e thirri shërbëtorin me emrin që kishte, por me emrin e babait të tij. Nga shkaku i kësaj sjelljeje, shërbëtori u mërzit dhe iu thye zemra përpara Sulltan Mahmudit. Kur e pyeti se përse e thirri kështu, miku i dashur i Pejgamberit, Gaznel Mahmudi dha këtë përgjigje:

“O biri im! Çdo ditë të kam thirrur me emrin tënd sepse kisha abdest, ndërsa tani nuk kam. Për këtë shkak u turpërova ta them emrin tënd pa abdest. Për këtë arsye të thirra me emrin e babait tënd.”



Perandoria Osmane ishte një perandori që shquhej për dashurinë që i gjithë populli kishte për Pejgamberin, duke filluar që nga padishahu e deri te



bariu më i thjeshtë. Krahës selameve që i dërgonin Pejgamberit ﷺ sa herë që i përmendej emri, por ishin bërë zakon edhe shfaqjet e panumërta ndërruese si, vendosja e dorës në zemër me respekt dhe dëgjimi në këmbë i rreshtave që shprehnin çastin e lindjes, kur lexohej Mevludi i Tij. Kur vinte posta e Medines së Ndriçuar, nuk kishte asnjë padishah Osman që ta lexonte letrën e ardhur pa marrë abdest të ri, pa e puthur, pa i fshirë sytë me të dhe pa u ngritur në këmbë.

Mbi të gjitha, ndrojtja që kishin Osmanët për të mos e shqetësuar të Dërguarin e Allahut në riparimin e Xhamisë së Tij; çdo gur e vendosnin në vendin e tij me abdest dhe me besmele, mbështjellja e çekiçëve me shajak, etj, ishin shembuj të një edukate dhe respekti i pashoq.

Po ashtu, në kohën e Osmanëve Surre Ala, që dërgohej në Medinetu'l-Munevvera, para se të hynte në qytet, qëndronte në një vend afër saj, përgatiteshin për atmosferën shpirtërore të Medinetu'l-Munevvera dhe pasi konsultoheshin në kuptim figurativ, shkonin para të Dërguarit të Allahut dhe e kryenin vizitën e tyre. Edhe kur ktheheshin, sillnin nga dheu i bekuar i Medinetu'l-Munevveras si shërim dhe bereqet.

Puplat në majë të çallmave të padishahëve Osmanë, vihen re në portretet e asaj kohe, ishin një maskë fshese. Përmes kësaj ata shprehnin dhe pranonin se ishin fshirësit e Haramejnit sh-Sherifejn,

dhe shpërblimin e atyre që kishin marrë përsipër pastrimin e Haramejnëve, e paguanin me paratë e tyre.



Sa shenjë e madhe e dashurisë dhe e respektit është që qimet e flokëve dhe të mjekrës së Pejgamberit ﷺ të jenë bereqet dhe mëshirë për ummetin prej shekujve, me emrin “Mjekra Fisnike”, duke i fshehur në dyzet bohçe në minberet e xhamive si një dhuratë fisnike nga i Nderuari ynë.



Sulltan Javuz Selimi pati çliruar Egjiptin. Edhe administrata e krahinës së Hixhazit i ishte dorëzuar atij. Më 20 shkurt, ditë e premte, hatibi foli për të në Xhaminë Melik Muejjed dhe tha:

“Hakimu’l-Haramejni’sh-Sherifejn” (Sunduesi i dy vendeve fisnike Mekke dhe Medine). Javuzi e ndërpreu fjalën e hatibit dhe u përgjigj me sy të përлотur:

“-Jo, jo! Përkundrazi, Hadimu’l-Haramejni’sh-Sherifejn (Shërbëtori i dy vendeve fisnike Mekke dhe Medine). Pastaj hoqi qilimin dhe falenderoi Zotin, duke i bërë sexhde në tokë. Për ta shfaqur se ai ishte Hadimu’l-Haramejni’sh-Sherifejn, vendosi një pupël mbi çalmën e tij, pupël që simbolizonte fshehtësinë.

Edhe këto fjalë që i tha pashait të moshuar, të cilit i kishte dhënë detyrën si padishah në këto vende



të bekuara, janë një shfaqje e singertë e dashurisë që kishte ndaj Pejgamberit ﷺ:

“O pasha! Padishahllëku i Mekkes dhe i Medines është në dorën e bijve të nderuar të të Nderuarit të Gjithësisë. Unë nuk e kam marrë atë vend me ushtri. Ata m’u bindën mua për hir të bashkimit Islam, për shkak të përsosmërisë, edukatës dhe mirësisë që kanë. Shpërblimi i këtij nderi është vaxhib për mua. Unë e falenderoj Allahun Teala natë e ditë, që emri im përkujtohet në hytbet të cilat mbahen në këto vende të bekuara. Këtë lumturi nuk e ndërroj edhe me sundimin e të gjithë botës! Për këtë arsye mos kurse asgjë që në lidhje me nevojat që ka populli i Haramejni’sh-Sherifejn dhe mos u orvat të ndërhysh gjë në punët e këtyre dy vendeve!”



Gjyshërit tanë të bekuar kanë shfaqur gjatë shekujve një respekt dhe dashuri të papërkufizueshme ndaj kujtimeve dhe amaneteve të shenjta të të Dërguarit të Allahut. Për të parë disa nga këto shembuj të shkëlqyer, është e mjaftueshme që t’i hedhim një sy historisë së amaneteve të shenjta, që gjyshërit tanë u shërbenin shumë dhe i pranonin si të tilla me një nder të madh.

Sulltanët Osmanë që nuk dëshironin të largoheshin qoftë edhe një çast nga Hirkatu’s-Saade e Pejgamberit të Nderuar, edhe në vendet ku shkonin e merrnin me vete në mënyra të ndryshme. Po ashtu edhe në Sarajën Istavro, e cila tashmë gjendet në



vendin ku është Saraja e Bejlerbejit dhe në Sarajën e vjetër të Edirnesë, u ndërtua nga një dhomë e Hirkatu's-Saade, si ajo që është në Topkapë.

Hirkatu's-Saaden e merrnin edhe në luftëra. Është shumë tërheqëse një miniaturë në të cilën përshkruhet njëra nga këto luftëra. Siç kuptohet nga miniatura, gjatë udhëtimit për në luftë Hirkatu's-Saade transportohej mbi kokat e ushtarëve mbrojtës, të cilëve u ishte ngarkuar kjo detyrë.

Mehmedi III i cili ishte një nga Sulltanët Osmanë, edhe pse nga pikëpamja e karakterit ishte padishah shumë i ashpër dhe nervoz, ishte gjithashtu një personalitet i mbushur me dashurinë e Pejgamberit. Kur përmendej emri fisnik i të Dërguarit të Allahut ﷺ, ai e shfaqte dashurinë dhe respektin që kishte ndaj Tij duke u ngritur në këmbë. Kur Mehmedi III shkoi në luftën e Egrit, mori me vete Flamurin Fisnik dhe Hirkatu's-Saade. Kur gjatë luftës mes myslimanëve ndodhi një mosmarrëveshje, hoxha i Sulltanit, Sadeddin Efendi i dha fetva padishahut që të veshë Hirkatu's-Saade, duke i thënë:

“O padishahu im! Është e përshtatshme që një Sulltan i lartë që është halife në rrugën e Pejgamberit alejhisselam të veshë Hirkatu's-Saade në raste të tilla dhe t'i lutet Allahut”. Pasi Sulltan Mehmedi III e veshi Hirkatu's-Saade me salate, selam dhe tekbire, ushtarët e Islamit u mbushën me entuziazëm të thellë dhe më në fund korrën një fitore të sigurtë.



Sulltan Ahmed Hani, gjatë ndërtimit të xhamisë e cila do të përkujtohej me emrin e tij, solli në tyrben e Ejjub Sulltanit gjurmët e këmbëve të bekuara, që në arabisht quhen “Nakshu’l-Kadem”. Kur mbaroi ndërtimi i xhamisë, ato i vendosi te kjo xhami.

Por, natën kur u transportuan ato, Sulltani pa një ëndërr të tillë:

“Ishte krijuar një kuvend i lartë në të cilin ishin mbledhur të gjithë Sulltanët, ndërsa Pejgamber ishte ulur në vendin e gjykatësit. Pothuajse ishte krijuar në lloj gjykate. Sulltan Kajëtbaj ishte ankuar nga Sulltan Ahmed për shkak se kishte sjellë në Stamboll Kademu’s-Saade, të cilat ishin shkak për vizitën e tyrbes së tij. I Dërguari i Allahut ﷺ me kompetencën e gjykatësit gjykoi që Kademu’sh-Sherif duhet të kthehet prapa menjëherë...”

Sulltan Ahmed Hani u zgjua me trishtim dhe frikë. Ai u tha dijetarëve dhe të urtëve, mes të cilëve ndodhej edhe Aziz Mahmud Hydaji, që ta komentonin atë. Ata thanë:

“O Sulltani ynë! Ëndërra është shumë e qartë dhe nuk ka nevojë për komentim. Amaneti duhet të kthehet prapa menjëherë...”

Sulltan Ahmed Hani i, i cili ishte mik i dashur i Pejgamberit, iu bind vendimit që u mor dhe i mërzi-tur e ktheu amanetin me një përpikmëri të madhe, por Ahmed Hani i, të cilit i digjej zemra nga dashuria që kishte ndaj Pejgamberit, u bëri një maket

mbi mermer gjurmëve të këmbëve të bekuara të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai u mundua të marrë begati nga mendimet e përbashkëta, duke i vendosuar ato në arkën më pambuk. Këto vargje që dalin nga zemra e tij e djegur, e reflektojnë shumë bukur dashurinë që kishte:

Çfarë ka nëse të mbaj vazhdimisht si kurorën time

Këmbën e pastër të Pejgamberit ﷺ...

Ajo këmbë zotëron kopështin e trëndafilave të profetësisë,

Vëre në fytyrë këmbën e Ahmedit që është si trëndafil!..



Abdulaziz Hani, i cili ishte një padishah i dashuruar shumë me të Dërguarin e Allahut ﷺ, pati dërguar në Medine një letër shumë të ndjeshme që bënte fjalë për Pejgamberin, për t'u vendosur në Ravdatu'l-Mutahhara.

Tani po paraqesim disa fjali nga kjo letër!

“Bismillahi’rr-Rrahmani’rr-Rrahim.

Falënderimi i takon Allahut i cili është i vetëm!

Salatet dhe selamet qofshin mbi ty o i Dërguari i Allahut!

Salatet dhe selamet qofshin mbi ty o i Dashuri i Allahut!



Salatet dhe selamet qofshin mbi ty o Pejgamberi i këtij ummeti!..

Ai e respektonte miqësinë dhe ishte shenja e pandryshuar e mirësisë dhe bujarisë, ishte ai i cili u lartësua me këtë lavdërim të lartë, “Sikur të mos ishte Ti, nuk do ta krijoja gjithësinë!”, ishte burimi i krenarisë së krijesave, i nderuari i të nderuarve, ndërmjetësuesi ynë, vendstrehimi ynë, ishte ai që çdo punë e bënte të pastër dhe me mendjemprehtësi, atij edhe pluhuri i këmbës i shkëlqente, ai ishte edukuesi më i lartë i botës së krijesave, zotëruesi i gjurmëve të begata që përhapnin erë të mirë, dashuria e tij mbushte tërë gjithësinë, i fundit i pejgamberëve, i nderuari i ditës së gjykimit, ndërmjetësuesi i mëkatarëve nga ummeti i tij, bukuria e kuvendit unik, bukuria e çatisë së oborrit të pejgamberëve, sunduesi i kuvendit të profetësisë, pejgamberi i atyre që hyjnë në rrugën e Allahut të Butë. Ishte i dashuri i Allahut të Mëshirshëm.

Ai që kam për qëllim me këto cilësi, është Muhamed Mustafa...

Mora guximin ta lyej fytyrën time të zezë dhe të mjerë me dritën e tij dhe me dheun e pastër si ujë të varrit të tij të ndritshëm, me përgjërim, edukatë dhe me shumë ndjenja të mia të fshehta. Mora guxim që me ballin tim që meriton të ndëshkohet, të bëj këtë kërkesë e cila është shfaqja e brengave ndaj derës së tij ku shpërthejnë erëra të bukura.

Falenderimi i takon Allahut, i Cili më ndihmoi dhe më dha sukses që me mirësi, me nder dhe me devotshmëri, të bëhem ummet i përsosur në besnikëri i të Dashurit të Allahut, i cili është hëna e plotë e hënave të botës së melekutit dhe i cili kishte aq shumë bereqet sa që edhe dielli ndriçues i qiellit të xheberutit turpërohej dhe merrte dritë nga ai, të bëhem ummet i mikut të Allahut i cili është i Mëshirshëm dhe furnizues dhe i kryekomandantit të të devotshmëve, të cilët meritojnë bukuritë dhe mirësitë më të mira...

Përsëri falenderimi i takon Allahut i Cili më bëri roje të rrobës së bukur (Hirkatu's-Saade) që është marrë nga vendi ku mblidhen engjëjt (nga Pejgamberi e Medineja) dhe nga ekzistenca e buri- mit të bujarisë mëshirore të përsosur, të nderuar dhe të bereqetshme, që ishte mirësia e xhennetit të krijesave të larta dhe të atyre që ishin të nderuar e te bekuar...

Inshallah fitoj ndërmjetësimit tënd ditën e shpër- blimit dhe të ndëshkimit, ditën kur Pasuria dhe fëmi- jët të mos kenë asnjë dobi. (Shura, 88) si vazhdim i kësaj mirësie. Ja, unë Abdulaziz Han Gazi, i biri i Mahmud Hanit, që është fajtor, mëkatar dhe mosbi- ndës prej ummetit tënd, që bëj lutje dhe përgjërohem natë e ditë për të të takuar ty me ata që hyjnë të parët në Xhennet, pohoj çdo faj dhe mosbindje që kam bërë dhe se do të merrem në llogari para të Nderuarit tonë, lavdisë së profetësisë. Mora guximin

të shfaq këtë gjendjen time të mbushur me fatkeqësi (e shpreha këtë të vërtetë për të marrë ndërmjetësimin tënd, o i Dërguari i Allahut, te dera jote që shpërndan mëshirë.)

I kërkoj falje Allahut për të gjitha mëkatet e mia! Përsëri i kërkoj falje Allahut!..

Ndërmjetësim, ndërmjetësim o i Dërguari i Allahut! Mos më lër të vetëm!..

O babai i Fatimetu'z-Zehra radijallahu anha! Salatet dhe selamet qofshin mbi Ty!

O gjyshi i Hasanit dhe i Husejnit! Salatet dhe selamet qofshin mbi Ty!

O i Nderuari i paraardhësve dhe i pasardhësve! Salatet dhe selamet qofshin mbi Ty!...



Edhe Abdulhamid Hani i II, i cili ndërtoi linjën hekurudhore të Hixhazit, me qëllim që muslimanët e botës të shkojnë dhe të vijnë lehtë nga Harami, urdhëroi që të bëhen stacione në vendet ku kishte pushuar Pejgamberi nëpër udhëtime, ashtu që kjo hekurudhë të ishte e përshtatshme ndaj sunnetit të lartë. Ja, me një dashuri të tillë i kishte bërë hekurudhat deri në Medine.



Poezitë dhe vjershat e poetëve që shfaqin dashurinë e tyre ndaj të Dërguarit të Allahut, janë



aq shumë sa që mund të bëhen libra me vëllime. Sa bukur thotë poeti Nabi:

Unë të lavdërova Ty për arsye se shumë pemë,
gurë, bimë dhe krijesa të pashpirtëra erdhën dhe
folën para teje.”

Një nga të urtët e mëdhenj të kohëve të fundit,
M. Es'ad Erbili, e ka shprehur kështu zjarrin për-
vëlues të dashurisë që ndjente për Profetin:

*Nga shfaqja e bukurisë sate, i dashuri im,
pranvera digjet flakë!*

*Trëndafili, bilbili, zymbyli, tokë e gjemba
digjen flakë!*

*Rrezet e bukurisë tënde i djegin tërë të dashu-
ruarit;*

*Gjuha digjet, gjoksi digjet; këta dy sy të lotuar
digjen flakë!*

*A mund të lahet dëshmori i dashurisë që kaq
zjarr?*

*Kurmi i digjet, qefini i digjet, uji i ëmbël për
ta larë digjet flakë!*

Sa të bukura janë këto vargje të poetit lirik dhe
sentimental të kohëve të vona, të mbiquajtur Jaman
Dede i cili, megjithëse i krishterë, pas shijimit të
kënaqësisë së njohjes së të vërtetës Muhamedane,
qe kthyer në një besimtar syperlotur dhe në një të
dashur të pasionuar të Profetit:

*Pa ujë në mbetsha, në shkretëtirë shpirt në
dhënça, dhimbje s'ndjej;*

Në gjoks më vlojnë vullkane, në oqeanë freskim s'ndej;

Flakë në lëshofshin nga qiejt dhe më prekin, s'ndej;

Me bukurinë tënde më lehtëso se u dogja, o Resulullah!

Ç'fat të mbyll sytë me dashurinë, në rrugën tënde të jap shpirt!

A s'mund të më takojë, mbreti im, në intimitetin tënd të jap shpirt?

Me sytë në të shuar, e lehtë në vëllazërinë tënde të jap shpirt!

Me bukurinë tënde më lehtëso se u dogja, o Resulullah!

E përkula qafën, i dërrmuar jam, shërimi i këtij mjerimi është tek ti!

M'u përcëlluan buzët nga zjarri, m'i lehtëson kur përmendesh ti!

Kurtëta dojë zemra, përkëdhele këtë Kitmirin, ti!

Me bukurinë tënde më lehtëso se u dogja, o Resulullah!

Një kujtim që tregon nivelin e afërsisë dhe dashurisë së poetit të këtij panegjiriku për Profetin, na e përcjell kështu njëri nga nxënësit e tij:

“Një ditë, pasi mbaruan mësimet, dolëm nga shkolla. Ishte kohë dreke dhe unë po shkoja për në Taksim. Afër rezidencës gjermane ndodhej një

xhami. Ja, që aty, po shkoja lart i vetëm. Veç kur e pashë Jaman Dedenë! Ishte mbështetur në murin e xhamisë dhe kishte marrë një pamje sikur po jepte frymën e fundit. Po rrinte ashtu, i dobët e i pafuqishëm, me kokën të rënë para, lehtësisht në anë të djathtë, me qafën të përkulur.

Vrapova menjëherë dhe i shkova pranë. E pyeta:

“Të shkuara, mësues, të qoftë për të mirë, çfarë ke, a mos je i sëmurë?”

Ndërkaq, e pashë se po qante! Prandaj e pyeta:

“Pse po qan, o mësues? A mos të ka ndodhur gjë?”

Me një zë shumë të hollë e të dridhur, Jaman Dede më tha:

“Jo, o bir, jo! Kur më vjen ndërmend i Dërguari i Allahut ﷺ, e humbas veten, s’më mbetet më fuqi për të qëndruar në këmbë! Ose më duhet të mbështetem diku, ose të ulem!”



Shkurtimisht, mund të themi se ka shembuj të panumërt të shfaqjes së dashurisë së pa matë të umetit ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ne këtu sollëm vetëm disa shembuj si pikat e ujit prej oqeanit.


Një gjë e dimë mirë, se e vetmja dashuri e vër-



tetë që e orienton njeriun tek dashuria për Allahun, është dashuria për Profetin ﷺ. Kjo, sepse dashuria për Profetin, është dashuri për Allahun; bindja ndaj tij, është bindje ndaj Allahut dhe kundërshtimi i tij, është kundërshtim i Allahut.

Allahu na e bëftë të mundur që zemrat tona të marrin frymëzim prej botës shpirtërore të Profetit ﷺ, që është udhëzuesi i vetëm në rrugën e drejtë. Qofshin zemrat tona vendi i përjetshëm i dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ. Allahu i Madhëruar na e bëftë të mundur të gjithëve ndërmjetësimin e Profetit ﷺ!

Amin!..



PËRMBYLLJE

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Njeriu është bashkë me atë që do!” (Buhari, Edeb, 96.)

Të jesh bashkë me Profetin ﷺ, në botën tjetër, të jesh pranë tij, është dëshira më e madhe e çdo besimtari. Dhe, për të arritur këtë mirësi, duhet ta duam të Dërguarin e Allahut në kuptimin e vërtetë të fjalës. Mirëpo, peshorja e dashurisë, është sakrifica. Për të qenë bashkë me Profetin ﷺ, duhet të zotërojmë ndjenja, mendime, moral dhe vepra të ngjashme me të.

Pra, nuk mjafton të thuash, “Unë e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ”! Kjo, sepse tek ai që dashuron dikë me të vërtetë, gjenden edhe cilësitë e atij që dashuron.

Nëse e duam të Dërguarin e Allahut ﷺ, sa prej cilësive të tij, si morali dhe devotshmëria, gjenden edhe tek ne? Nëse e duam atë, në çfarë niveli i kemi



mëshirën, butësinë, shërbimin në rrugë të Allahut, përpjekjet dhe sakrificat tona? A kemi mundur të shpëtojmë prej egoizmit, koprracisë dhe paedukatës? Sa na interesojnë hallet e myslimanëve? Sa e zbatojmë sunnetin e Profetit ﷺ, në jetën tonë? Apo mos vallë në ndonjë pjesë të jetës sonë e harrojmë dhe e anashkalojmë atë?

Ja pra, për të bërë pjesë në hadithin, “njeriu është bashkë me atë që do!”, duhet të peshojmë dashurinë tonë me nivelin e të qenit bashkë me Profetin e Zotit ﷺ.

Kadi Ijad ka thënë:

“Një nga kushtet e dashurisë ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ, është edhe kapja pas sunnetit të tij, të mbrosh fenë që ka kumtuar ai, të asgjësosh sulmet e drejtuar ndaj tij dhe nëse është e nevojshme, të sakrifikosh pasurinë dhe jetën në rrugën e tij.”

Le të pyesim veten:

Sa kemi mundur të përfitojmë prej botës së zemrës së Profetit ﷺ?

Për shembull;

Çfarë pjekurie shpirtërore kanë “adhurimet tona”?

Pra, a na çojnë adhurimet tona drejt dashurisë dhe thellësisë së ndjenjave? Sa e arrijmë përkushtimin dhe qetësinë e zemrës në adhurime?

Në çfarë niveli është “delikatesa në sjelljet tona”?

Sa mëshirë ka në zemra tona? Sa mëshirë përhapet prej tyre? A përfundojnë veprat tona me “Allahu të shpërbleftë”, apo me “E paç haram!”?

Në ç’masë është “pjekuria e moralit tonë”?

A është mirësjellja që tregojmë ndaj të tjerëve në të njëjtin nivel me delikatesën që presim prej tyre? A kemi mundur të shpëtojmë prej egoizmit, vetëpëlqimit dhe mendjemadhësisë? A është e sinqertë modestia jonë?

Sa e thellë është “butësia e zemrave tona”?

Sa i duam krijesat për hir të Krijuesit? Sa mëshirë tregojnë zemrat tona për nevojtarët dhe të vetmuarit? Sa përfshirëse dhe sa ndikuese është mëshira jonë?

Sa ndriçon “drita në fytyrat tona”?

Në ajetin fisnik ku numërohen cilësitë e besimtarëve që do të jenë bashkë me Profetin ﷺ, urdhërohet: “**...Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes...**” (Fet’h, 29) Pra, sa reflektohet sexhdeja në fytyra tona?

Sa harmonike është “rrjedhshmëria e gjuhëve tona”?

Sa qetësi u japin gjuhët tona shpirttrave? Sa i rehatojnë ato njerëzit që kanë përballë?

Në ç'shkallë është “hollësia e ndjenjave tona”?

A jemi të vetëdijsëm se të gjitha krijesat na janë lënë neve amanet? Sa të ndjeshëm jemi ndaj shenjave të Allahut, ndaj përgjegjësiwe tona dhe ndaj vdekjes dhe kiametit që po afrohet? A na dridhen zemrat? A na lotojnë sytë?

Në cilat horizonte është “thellësia e shikimeve tona”?

Sa arrijnë zemrat tona t'i shohin manifestimet e fuqisë hyjnore? Sa arrijmë ta zbatojmë urdhrin hyjnor, “اقْرَأْ / Lexo!”? Sa kemi arritur të shpëtojmë prej dijes sipërfaqësore, të thatë dhe të padobishme? Sa jemi thelluar në misteret dhe urtësitë hyjnore?

Shkurtimisht;

Sa kemi përfituar prej moralit të lartë dhe detit të gjerë shpirtëror të Profetit ﷺ, për të cilin ajeti fisnik shprehet duke e lavdëruar: “(O Muhamed!) **Padyshim se ti je me moral të lartë!**” (Kalem, 4.)? Sa gjenden tek ne prej të gjitha bukurive të atij Profeti të lartë, prej zemrës së të cilit rridhte mëshirë për botët?

Lum ata prej ummetit të Muhamedit që arrijnë t'i japin përgjigje pozitive këtyre pyetjeve të nxehta dhe këtyre llogarive të thella! Lum ata që ndahen nga kjo botë dhe shkojnë në botën tjetër si trashëgimtarë të Profetit ﷺ dhe si dëshmitarë të Allahu të Madhëruar!

Allahu e bëftë dashurinë për Vetën dhe të Dërguarin e Tij ﷺ, thesarin e pashterueshëm të zemrave tona! Allahu na e bëftë të mundur me bujarinë e Tij, që të nderohemi në këtë botë me cilësinë e të qenit “vëllezër” të Profetit ﷺ, të freskohemi në burimin e tij të Keutherit në botën tjetër dhe gëzojmë ndërmjetësimin e tij në flamurin e Hamdit!

Amin!..



PËRMBAJTJE

PARATHËNIA	5
Dashuria për peygamberin.....	13
Ai është shembulli më i përsosur	14
Dashuria e madhe	17
Ai është një pishtar që ndriçon.....	18
Ai është kriteri i vetëm për të gjetur të vërtetën	20
PANORAMA DASHURIE	25
PËRMBYLLJE.....	115

